



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2022

PËR

MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

PJESA I

OBJEKTI DHE PARIMI I PËRGJITHSHËM

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të tyre.

Neni 2

Fusha e zbatimit lëndor

1. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale tërësisht ose pjesërisht, me mjete automatike, si dhe për përpunimin që nuk kryhet me mjete të automatike, nëse të dhënat janë pjesë e një sistemi arkivimi ose kanë për qëllim të bëhen pjesë e një sistemi arkivimi.

2. Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga individët, për qëllime personale ose familjare.

Neni 3

Fusha e zbatimit territorial

1. Ky ligj zbatohet për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të veprimtarive të një kontrolluesi ose përpunuesi të vendosur në Shqipëri, pavarësisht nëse përpunimi zhvillohet në Shqipëri ose jo.
2. Ky ligj zbatohet gjithashtu për përpunimin e të dhënave personale nga kontrollues ose përpunues që nuk janë të vendosur në Shqipëri, por ku ligji shqiptar zbatohet në bazë të së drejtës ndërkombëtare publike.
3. Ky ligj zbatohet edhe për përpunimin e të dhënave nga kontrollues, që nuk janë të vendosur në Shqipëri, por proceset e përpunimit kanë të bëjnë me:
 - a) ofrimin e mallrave ose shërbimeve, me kundërshtpërbllim ose jo, tek subjekte të të dhënave në Shqipëri, ose
 - b) monitorimin e sjelljes së personave, të cilët janë të vendosur brenda territorit të Shqipërisë. Në këto raste, kontrolluesi cakton një përfaqësues të vendosur në Shqipëri dhe njofton Komisionerin me shkrim për identitetin e përfaqësuesit.
4. Kur një kontrollues, për proceset e përcaktuara në paragrafin 3, kontraktton një përpunues i cili nuk është i vendosur në Shqipëri, zbatohet Seksioni 2 i Kapitullit I për Transferimet Ndërkombëtare të të Dhënave.

Neni 4

Parim i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale të individëve bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të tyre, dhe veçanërisht të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas përcaktimit të nenit 35 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Neni 5

Përkufizime

1. "Të dhëna personale" ("të dhëna") nënkupton çdo informacion në lidhje me një person të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekti i të dhënave"). Një person është i identifikueshëm nëse duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi, një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si emër, numër identifikimi, të dhënat e vendndodhjes, një identifikuesi në internet ose një ose më shumë faktorëve specifikë lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror, mund të arrihet në identifikimin e tij.
2. "Përpunim" nënkupton çdo veprim ose një grup veprimesh që janë kryer në lidhje me të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, përafrimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.
3. "Përpunim i mëtejshëm" nënkupton përpunimin e të dhënave për një qëllim të ndryshëm nga ai fillestar, i përcaktuar në momentin e mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë transferimin ose vënien në dispozicion të të dhënave për këtë qëllim të ri;

4. “Qëllim i pajtueshëm” nënkupton një qëllim të ri, i cili:
- a) zakonisht ose në pjesën dërrmuese të rasteve realizohet në kuadër të një aktiviteti në dukje të drejtë, së bashku me qëllimin fillestar të përpunimit, dhe që janë të përafërt si në kohë, ashtu edhe në kuptim të rrethanave, çka e bën përpunimin e mëtejshëm për atë qëllim të ri, të parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme nga një subjekt të dhënash, dhe i cili
 - b) nuk paraqet rreziqe të konsiderueshme të mëtejshme për subjektin e të dhënave ose këto rreziqe janë reduktuar nëpërmjet masave mbrojtëse shtesë të marra nga kontrolluesi për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të subjektit të të dhënave.
5. “Profilizim” nënkupton çdo formë përpunimi të automatizuar të të dhënave personale që konsiston në përdorimin e të dhënave për të vlerësuar aspekte të caktuara që lidhen me një person, veçanërisht për të analizuar ose parashikuar aspekte në lidhje me performancën e atij personi në punë, situatën ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij.
6. “Të dhëna të pseudonimizuar”, nënkupton të dhënat personale të përpunuara në mënyrë të tillë që ato nuk mund t’i atribuohen një subjekti specifik të dhënash pa përdorimin e informacioneve shtesë, me kusht që ky informacion shtesë të ruhet veçmas dhe t’i nënshtrohet masave teknike dhe organizative të marra me qëllim për t’u siguruar që të dhënat personale nuk mund t’i atribuohen një individi të identifikuar ose të identifikueshëm, përveçse kur diçka e tillë autorizohet në mënyrë specifike.
7. “Të dhëna të anonimizuar” nënkupton të dhëna, të cilat kanë qenë fillimisht të dhëna personale, por janë përpunuar në mënyrë të tillë që nuk është më e mundur t’i atribuohen një individi të identifikuar ose të identifikueshëm.
8. “Të dhëna sensitive” nënkupton kategoritë e të dhënave të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 9.
9. “Të dhëna gjenetike” nënkupton të dhënat personale që kanë të bëjnë me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të fituara të një personi, të cilat japin informacion unik në lidhje me fiziologjinë ose shëndetin e atij personi dhe që përftohen, veçanërisht, si rezultat i analizës së një kampioni biologjik nga personi në fjalë.
10. “Të dhëna biometrike” nënkupton të dhënat personale që rezultojnë nga përpunimi teknik specifik i karakteristikave fizike, fiziologjike ose të sjelljes së një personi, të cilat bëjnë të mundur ose konfirmojnë identifikimin unik të atij personi, siç janë imazhet e fytyrës ose gjurmët daktiloskopike.
11. “Të dhëna penale” nënkupton të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat e sigurimit që lidhen me to.
12. “Sistem arkivimi” nënkupton çdo grup të strukturuar të të dhënave personale, i cili është i aksesueshëm sipas kriterëve specifike që lidhen me personat, dhe që mund të jetë i qendëruar, i decentralizuar ose i shpërndarë në mënyrë funksionale ose gjeografike.
13. “Kontrollues” nënkupton një individ, person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër i cili, vetëm ose së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale.

14. "Kontrollues i ligjshëm" nënkupton një individ, person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër, i cili vendos të përpunojë të dhëna për një qëllim të caktuar dhe është i autorizuar me ligj për këtë përpunim; përcaktimi i kontrolluesit të ligjshëm për disa procese përpunuese ose kriteret specifike për caktimin e tij mund të parashikohen në mënyrë specifike në ligj.
15. "Përpunues" nënkupton një individ, person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që përpunon të dhëna personale për llogari të kontrolluesit, që nënkupton se përpunuesi përpunon të dhëna sipas ligjit në kuptim të neneve 7 deri në 10, për llogari të kontrolluesit.
16. "Marrës" nënkupton çdo individ, person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër, të cilit i janë përhapur dhe/ose vënë në dispozicion të dhënat personale, qoftë ky një palë e tretë ose jo.
17. "Palë e tretë" nënkupton një individ, person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër, përveç subjektit të të dhënave, kontrolluesit, përpunuesit apo personave të cilët, nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kontrolluesit ose përpunuesit, janë të autorizuar të përpunojnë të dhëna personale.
18. "Pëlqim" nga subjekti i të dhënave nënkupton çdo element tregues të vullnetit të subjektit të të dhënave, të dhënë lirisht, të informuar dhe të qartë nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklaratë ose me një veprim të qartë pohues, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale që lidhen me të, për një ose më shumë qëllime specifike.
19. "Komisioneri" nënkupton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është autoriteti i pavarur që monitoron dhe mbikëqyr të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit dhe që vepron në përputhje me dispozitat e Pjesës IV të këtij Ligji.
20. "Cenim i të dhënave (personale)" nënkupton çdo cenim të sigurisë që mund të shkaktojë shkatërrimin, humbjen, ndryshimin aksidental ose të paligjshëm ose, në përhapjen e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura, të transmetuara, ose të përpunuara në ndonjë mënyrë tjetër.
21. "Ndërmarrje" nënkupton një person fizik ose juridik të përfshirë në një aktivitet ekonomik, pavarësisht nga forma e tij juridike, përfshirë partneritetet ose format e tjera të organizimit të profesionistëve, të angazhuara rregullisht në një aktivitet ekonomik.
22. "Grup ndërmarrjesh" nënkupton një ndërmarrje kontrolluese dhe ndërmarrjet e kontrolluara prej saj.
23. "Transferimi ndërkombëtar i të dhënave" nënkupton transmetimin e të dhënave personale tek një marrës që i nënshtrohet një juridiksioni të huaj, që mund të jetë sistemi ligjor i një shteti të huaj ose një organizatë ndërkombëtare. Transmetimi i të dhënave personale tek përfaqësitë diplomatike të një shteti të huaj në Shqipëri konsiderohet transferim ndërkombëtar i të dhënave.
24. "Klauzola standarde të mbrojtjes së të dhënave" nënkupton kontratat tip, të miratuara dhe të publikuara nga Komisioneri, me qëllim garantimin e mbrojtjes së përshtatshme të të dhënave

në transferimet ndërkombëtare të tyre me marrëveshje midis dërguesit së të dhënave në Shqipëri dhe marrësit të të dhënave në një vend të huaj ose organizatë ndërkombëtare.

25. “Rregullat e detyrueshme të korporatave” nënkupton politikat e mbrojtjes së të dhënave personale të cilat zbatohen nga një kontrollues ose përpunues, i vendosur në territorin e Shqipërisë, në lidhje me transferimet ose një grup transferimesh të të dhënave personale tek një kontrollues ose përpunues i vendosur në një ose më shumë vende të huaja, pjesë e një grupi ndërmarrjesh, të angazhuar në një aktivitet të përbashkët ekonomik.

26. “Organizatë ndërkombëtare” nënkupton një organizatë dhe organet e saj të cilat rregullohen sipas të drejtës ndërkombëtare publike, ose ndonjë organ tjetër i cili është krijuar me ose në bazë të një marrëveshjeje midis dy ose më shumë vendeve.

27. “Kod sjellje” nënkupton një grup rregullash, të miratuara nga Komisioneri dhe të krijuara nga kategori ose degë kontrolluesish ose përpunuesish, në mënyrë që të trajtojnë në detaj zbatimin e dispozitave të këtij Ligji në sektorë specifik.

28. “Mekanizëm certifikimi” nënkupton listën e kriterëve për përpunim të ligjshëm sipas këtij Ligji, të miratuar nga Komisioneri dhe të zbatuar nga një organ certifikues në procedurat e tij të certifikimit.

PJESA II

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE ME PËRJASHTIM TË ÇËSHTJEVE TË RREGULLUARA NË PJESËN III

KAPITULLI I

Përpunimi i të dhënave personale

Seksioni 1

Kriteret për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale

Neni 6

Parimet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale

1. Të dhënat personale duhet të:

- a) përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente kundrejt subjektit të të dhënave (“parimi i ligjshmërisë”);
- b) mbliidhen për një qëllim specifik dhe legjitim, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar, përveç nëse përpunimi i mëtejshëm parashikohet me ligj të veçantë, për shkak të interesit publik, ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve, duke respektuar thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe në atë masë që është e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e interesit, ose, nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij (“parimi i përpunimit në përputhje me qëllimin”);
- c) jenë të përshtatshme dhe të nevojshme për qëllimin e përpunimit dhe kufizohen në atë që është e nevojshme për realizimin e qëllimit (“parimi i mjaftueshmërisë së të dhënave”);
- d) jenë të sakta, dhe nëse është e nevojshme, të përditësuara. Duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, duhet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për t’u siguruar që të dhënat të

cilat janë të pasakta ose të paplota, të fshihen ose të korrigojnë pa vonesë (“parimi i saktësisë së të dhënave”);

- e) mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për jo më shumë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato përpunohen. Të dhënat personale mund të ruhen për periudha më të gjata, me kusht që të dhënat personale të përpunohen vetëm për qëllime arkivimi në interesin publik, qëllime kërkimore shkencore ose historike ose qëllime statistikore, me kusht që të zbatohen masat e duhura teknike dhe organizative, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave (“parimi i mbajtjes së kufizuar në kohë”);
- f) përpunohen në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e nevojshme e të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm dhe humbja, shkatërrimi ose dëmtimi aksidental, nëpërmjet përdorimit të masave të duhura teknike dhe organizative (“parimi i integritetit dhe konfidencialitetit”).

2. Kontrolluesi është përgjegjës dhe duhet të jetë në gjendje të provojë përputhshmërinë me paragrafin 1 (“parimi i përgjegjshmërisë”).

Neni 7

Kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale

Përpunimi është i ligjshëm vetëm nëse të paktën një prej kriterëve të mëposhtme është i zbatueshëm:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin;
- b) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një kontrate ku subjekti i të dhënave është palë, ose për ndërmarrjen, me kërkesë të subjektit të të dhënave, të hapave që i paraprijnë nënshkrimit të një kontrate;
- c) përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër;
- d) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- e) përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen nga kontrolluesi të një detyre ligjore me interes publik dhe/ose ushtrimin e kompetencave ligjore;
- f) përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e interesave legjitimë të kontrolluesit ose të një pale të tretë, përveç kur interesat ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkojnë mbrojtje të të dhënave personale, veçanërisht kur subjekti i të dhënave është fëmijë, kanë përparësi mbi këto interesa.

Kjo pikë nuk zbatohet për përpunimin që kryhet nga autoritetet publike në përmbushjen e detyrave të tyre sipas pikës (e).

Neni 8

Kriteret për vlefshmërinë e pëlqimit

1. Kur përpunimi kryhet mbi bazë pëlqimi, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të provojë që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave që lidhen me të.

2. Nëse pëlqimi i subjektit të të dhënave jepet në kontekstin e një deklaratë me shkrim e cila përfshin edhe çështje të tjera, kërkesa për pëlqim paraqitet në mënyrë të tillë që të dallohet qartë

nga çështjet e tjera, në një formë të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë. Nuk është e detyrueshme, asnjë pjesë e kësaj deklarate që përbën shkelje të këtij ligji.

3. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën ta tërheqë pëlqimin e tij në çdo moment. Subjekti i të dhënave informohet mbi këtë të drejtë përpara dhënies së pëlqimit. Tërheqja e pëlqimit nuk cenon ligjshmërinë e përpunimit bazuar mbi këtë pëlqim përpara tërheqjes së tij. Pëlqimi tërhiqet po aq lehtë sa dhënia e tij.

4. Pëlqimi nuk konsiderohet i dhënë lirisht, kur ekzistojnë elementë detyrimi, presioni ose paaftësie për të ushtruar vullnetin e lirë. Kjo situatë mund të diktohet nga kushte pabarazie midis kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave, siç mund të jetë ndër të tjera, rasti kur një autoritet publik kërkon pëlqim nga një qytetar, ose një punëdhënës nga një punëmarrës.

5. Kur pëlqimi për përpunimin e të dhënave kërkohet në një dispozitë e cila është pjesë e pandashme e një kontrate, megjithëse përpunimi nuk është i nevojshëm për zbatimin e asaj kontrate, pëlqimi nuk është i vlefshëm, përveçse kur kontrolluesi provon se pëlqimi është dhënë lirisht, veçanërisht edhe kur subjektit të të dhënave i janë ofruar zgjedhje të tjera, dhe megjithatë ai vendos të pranojë dispozitën kontraktore.

6. Nëse në kuadër të ofrimit në internet të mallrave ose shërbimeve të drejtpërdrejtë të një fëmije, mbliidhen të dhëna dhe përpunohen mbi bazën e dhënies së pëlqimit nga ana e fëmijës, pëlqimi është i vlefshëm nëse fëmija është të paktën 16 vjeç. Kur fëmija është nën moshën 16 vjeç, përpunimi është i ligjshëm vetëm nëse dhe me kusht që pëlqimi të jepet ose të autorizohet nga kujdestari ligjor i fëmijës.

Neni 9

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave sensitive

1. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, ndalohej përpunimi i të dhënave që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, përpunimi i të dhënave gjenetike ose të dhënave biometrike me qëllim për të identifikuar në mënyrë unike një person, si dhe i të dhënave në lidhje me shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi.

2. Me kusht që të zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të subjekteve të të dhënave, lejohet përpunimi i të dhënave sensitive në rastet kur:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij të qartë, përveç kur parashikohet me ligj të veçantë që ndalimi i përpunimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të derogohet me anë të pëlqimit nga subjekti i të dhënave;
- b) përpunimi i të dhënave është i nevojshëm për përmbushjen e një detyrimi ose të drejte specifike të kontrolluesit ose të subjektit të të dhënave në fushën e punësimit ose sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, duke përfshirë detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga një marrëveshje kolektive, në përputhje me dispozitat ligjore në këto fusha;
- c) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të subjektit të të dhënave dhe ky i fundit është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e tij, si dhe, në rastet kur është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të një personi tjetër;

- d) është i nevojshëm për veprimtarinë e ligjshme të organizatave jofitimprurëse politike, filozofike, fetare dhe sindikaliste, me kusht që përpunimi të lidhet vetëm me anëtarët ose ish-anëtarët e organizatës ose me persona që kanë kontakte të rregullta me të në kuadër të veprimtarisë së saj, si dhe që të dhënat personale të mos përhapen jashtë organizatës pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave;
- e) lidhet me të dhëna që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave dhe përpunimi është i nevojshëm për realizimin e një interesi të ligjshëm;
- f) është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e një pretendimi ligjor përpara gjykatave ose organeve administrative;
- g) është i nevojshëm për një interes thelbësor publik dhe parashikohet me ligj të posaçëm i cili është proporcional me qëllimin e ndjekur dhe respekton thelbin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave;
- h) është i nevojshëm për qëllime të mjekësisë parandaluese ose në kuadër të dëmeve të shëndetit në punë, për vlerësimin e aftësisë për punë të punonjësit, për diagnostikimin mjekësor, për ofrimin, trajtimin ose menaxhimin e shërbimeve shëndetësore ose të kujdesit shëndetësor sipas ligjit ose në zbatim të një kontrate me një profesionist të kujdesit shëndetësor dhe me kusht që personat që ofrojnë këto shërbime t'i nënshtrohen sekretit profesional ose të veprojnë nën përgjegjësinë e një profesionisti, i cili i nënshtrohet sekretit profesional;
- i) është i nevojshëm për arsye të interesit publik në fushën e shëndetit publik, si mbrojtja nga kërcënimet serioze ndërkuftare për shëndetin ose garantimi i standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor dhe produkteve ose pajisjeve mjekësore, sipas një ligji që garanton masa të përshtatshme mbrojtëse, në veçanti, detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional të personave që përpunojnë të dhënat personale;
- j) është i nevojshëm për qëllime arkivimi për interes publik, për qëllime historike, kërkimore shkencore ose qëllime statistikore, në përputhje me nenin 16.

Neni 10

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave penale

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat e sigurisë që lidhen me to, kryhen vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar kompetent ose kur përpunimi autorizohet me ligj, duke siguruar mbrojtje të përshtatshme për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave. Çdo regjistër qendror i gjendjes penale mbahet nën kontrollin ekskluziv të autoritetit zyrtar kompetent.

Seksioni 2

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

Neni 11

Parime të përgjithshme

1. Transferimi i të dhënave personale, të cilat janë në proces përpunimi ose do të përpunohen pas transferimit, në një vend të huaj ose në një organizatë ndërkombëtare, kryhet vetëm nëse

garantohet mbrojtja e duhur e të dhënave në destinacion, ose ajo sigurohet posaçërisht për atë transferim në përputhje me rregullat e mëposhtme. Të gjitha dispozitat e këtij Seksioni zbatohen në mënyrë që të sigurohet se niveli i mbrojtjes së të dhënave personale, i garantuar nga ky Ligj, nuk cenohet nga transferimi ndërkombëtar i të dhënave.

2. Vendimet e gjykatave, si dhe vendimet e organeve administrative të një shteti të huaj, që përcaktojnë detyrimin për një kontrollues ose përpunues të transferojë ose përhapë të dhëna personale, mund të njihen ose zbatohen vetëm nëse bazohen në një marrëveshje ndërkombëtare, siç mund të jetë një traktat për ndihmë të ndërsjelltë juridike, në fuqi midis shtetit të huaj kërkues dhe Republikës së Shqipërisë, pa cenuar kriteret e tjera për transferim të parashikuara në këtë Seksion.

Neni 12

Transferimi i të dhënave në vende me nivel të mjaftueshëm mbrojtje të të dhënave

1. Transferimi i të dhënave personale drejt shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare lejohet, kur marrësi ndodhet në një shtet, territor ose bën pjesë në një ose më shumë sektorë të caktuar brenda shtetit të huaj, ose, në një organizatë ndërkombëtare, që siguron nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave sipas paragrafit 2 të këtij neni.

2. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet, territor apo sektor të caktuar, apo për një organizatë ndërkombëtare, përcaktohet me vendim të Komisionerit, që publikohet në përputhje me paragrafin 1 të nenit 87, të këtij Ligji. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale në një shtet të huaj ose organizatë ndërkombëtare përcaktohet duke marrë parasysh:

- a) ekzistencën dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave,
- b) të gjitha rrethanat që lidhen me sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,
- c) legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij në fushat e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, duke përfshirë të drejtën penale,
- d) sa i takon fushës së mbrojtjes së të dhënave, veçanërisht ekzistencën e një sistemi efektiv për zbatimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, duke përfshirë një autoritet mbikëqyrës të pavarur për mbrojtjen e të dhënave dhe rishikimin efektiv gjyqësor, dhe
- e) nëse angazhimet ndërkombëtare të shtetit ose organizatës ndërkombëtare të vlerësuar janë të favorshme ose të pafavorshme për të siguruar mbrojtje efektive të të dhënave, veçanërisht sa i takon ratifikimit të Konventës së Modernizuar të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale (ETS Nr. 108, ndryshuar nga CM (2018) 2-përfundimtar).

3. Komisioneri monitoron zhvillimet në ato shtete ose organizata ndërkombëtare, të cilat janë vlerësuar me nivel të mjaftueshëm në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe rishikon vendimet e tij në përputhje me rrethanat.

Neni 13

Transferimi i të dhënave në vende me nivel të pamjaftueshëm mbrojtje të të dhënave

1. Kur të dhënat transferohen tek marrës në një vend me nivel të pamjaftueshëm mbrojtje në përputhje me nenin 12, transferimi lejohet, nëse:

- a) autorizohet nga instrumente ligjore ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe të zbatueshme drejtpërdrejtë nga kjo e fundit;
- b) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e informuar dhe të qartë për transferimin ndërkombëtar të të dhënave të propozuar (nuk zbatohet në sektorin publik);
- c) është i nevojshëm për zbatimin e një kontrate midis subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit, ose për zbatimin e masave parakontraktore, të ndërmarra me kërkesë të subjektit të të dhënave, ose transferimi është i nevojshëm për lidhjen ose zbatimin e një kontrate midis kontrolluesit dhe një pale të tretë, në interes të subjektit të të dhënave (nuk zbatohet në sektorin publik);
- d) është detyrim ligjor i kontrolluesit;
- e) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të subjektit të të dhënave, kur ky është i paaftë për të dhënë pëlqimin, ose të interesave jetikë të një personi tjetër;
- f) është i nevojshëm për shkak të interesit të rëndësishëm publik;
- g) është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;
- h) është bërë nga një regjistër që sipas ligjit, është i hapur për konsultim dhe ofron informacion për publikun e gjerë, me kusht që transferimi të përfshijë vetëm informacione të caktuara, dhe jo pjesë të plota të regjistrit;
- i) transferimi, që ka të bëjë vetëm me një numër të kufizuar subjektësh të të dhënave, është i nevojshëm për shkak të interesave legjitimë të rëndësishëm të kontrolluesit, të cilat kanë përparësi mbi interesat për mbrojtjen e subjekteve të të dhënave, me kusht që të jenë marrë masa të përshtatshme mbrojtëse nga kontrolluesi dhe subjektet e të dhënave dhe Komisioneri të jenë informuar për transferimin, i cili duhet të dokumentohet nga kontrolluesi.

Përveç transferimeve të përcaktuara në pikat a) dhe d), transferimi mund të kryhet vetëm për raste të veçanta dhe jo të përsëritura.

2. Në të gjitha rastet e tjera, transferimi me anë të një kontrate apo akti administrativ, mund të kryhet me autorizim nga Komisioneri, përveç nëse transferimi kryhet mbi bazën e një prej instrumenteve të mëposhtëm, që përmban masa të përshtatshme mbrojtëse për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave:

- a) një instrument ligjor i detyrueshëm dhe i zbatueshëm midis autoriteteve ose organeve publike;
- b) rregulla të detyrueshme të korporatave, të miratuara nga Komisioneri;
- c) klauzola standarde të mbrojtjes së të dhënave, të publikuara nga Komisioneri;
- e) një kod sjellje, të miratuar nga Komisioneri, së bashku me angazhimin e detyrueshëm dhe të zbatueshëm të marrësit në një vend me nivel të pamjaftueshëm mbrojtje të të dhënave ose në organizatën ndërkombëtare, mbi zbatimin e masave të përshtatshme mbrojtëse, përfshirë të drejtat e subjekteve të të dhënave; ose
- f) një mekanizëm certifikimi, të miratuar nga Komisioneri, së bashku me angazhimin e detyrueshëm dhe të zbatueshëm të marrësit në një vend me nivel të pamjaftueshëm mbrojtje të të dhënave ose në organizatën ndërkombëtare, mbi zbatimin e masave të përshtatshme mbrojtëse, përfshirë të drejtat e subjekteve të të dhënave.

Neni 14

Rregullat e detyrueshme të korporatave

1. Komisioneri mund të miratojë rregulla të detyrueshme për korporatat, të cilat përcaktojnë rregulla për përpunimin e të dhënave personale brenda një grupi ndërmarrjesh të përfshira në veprimtari të përbashkëta ekonomike, nëse këto rregulla përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- a) janë të detyrueshme dhe zbatohen nga çdo anëtar i grupit të ndërmarrjeve, përfshirë punonjësit e tyre;
- b) u japin shprehimisht të drejta të zbatueshme subjekteve të të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale; dhe
- c) përmbushin kriteret e përcaktuara në paragrafin 2.

2. Rregullat e detyrueshme të korporatave duhet të përcaktojnë të paktën:

- a) strukturën dhe të dhënat e kontaktit të grupit të ndërmarrjeve dhe të secilit prej anëtarëve të tij;
- b) transferimet e të dhënave ose grupin e transferimeve, përfshirë kategoritë e të dhënave personale, llojin e përpunimit dhe qëllimet e tij, llojin e subjekteve të të dhënave të përfshirë dhe shtetin ose shtetet e huaja ose organizatat ndërkombëtare në fjalë;
- c) natyrën detyruese të rregullave të korporatave, si atyre të brendshme dhe të jashtme;
- d) zbatimin e parimeve të përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave, siç përcaktohet në nenin 6;
- e) të drejtat e subjekteve të të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre dhe mjetet për ushtrimin e këtyre të drejtave, përfshirë mënyrën se si do të kryhet ushtrimi i këtyre të drejtave nga subjekti i të dhënave, siç është përcaktimi i procedurave të brendshme për ankesat;
- f) pranimin nga kontrolluesit ose përpunuesit e vendosur në Shqipëri, pjesë e grupit të ndërmarrjeve, të përgjegjësisë ndaj subjekteve të të dhënave në Shqipëri, për çdo shkelje të rregullave të detyrueshme të korporatave nga ndonjë anëtar i grupit, i cili nuk është i vendosur në Shqipëri, përveç nëse kontrolluesi ose përpunuesi shqiptar vërteton që anëtari në fjalë nuk është përgjegjës për ngjarjen që ka shkaktuar dëmin;
- g) mekanizmat e ngritur brenda grupit për të siguruar përputhshmërinë me rregullat, siç janë caktimi i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave, trajnimi i punonjësve, kryerja e auditeve, mekanizmat për raportimin dhe regjistrimin e shkeljeve ose masat korrigjuese;
- h) mekanizmat për raportimin dhe regjistrimin e ndryshimeve të rregullave dhe raportimin e këtyre ndryshimeve tek Komisioneri si autoriteti mbikëqyrës;
- i) mekanizmat e bashkëpunimit me autoritetin mbikëqyrës, duke përfshirë mekanizmat për raportimin e çdo kriteri ligjor të zbatueshëm në lidhje me një anëtar të grupit në një shtet të huaj dhe që mund të ketë një efekt negativ serioz në garancitë e parashikuara nga rregullat e detyrueshme të korporatave.

Seksioni 3

Përpunimi i të dhënave për qëllime të posaçme

Neni 15

Përpunimi i të dhënave personale dhe liria e shprehjes

1. Me qëllim harmonizimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave, të garantuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat

e Njeriut, me të drejtën e lirisë së shprehjes, të garantuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, artistike dhe letrare, zbatohen përjashtime nga dispozitat e këtij ligji, me kusht që ato:

- a) të jenë të nevojshme për përfshirjen dhe kontributin në këto veprimtari, dhe
- b) të jenë proporcionale me çështjen specifike të pasqyruar, dhe
- c) të respektojnë thelbin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave.

2. Veprimtari në fushën e gazetarisë janë aktivitetet që kanë për qëllim pasqyrimin e informacioneve, mendimeve ose ideve, të cilat kontribuojnë në debatin me interes publik, pavarësisht nga mënyra që përdoret për t'i transmetuar ato.

3. Përjashtimi i kontrolluesve nga detyrimet e këtij ligji sipas paragrafit 1 të këtij neni në lidhje me përpunimin e të dhënave për qëllime gazetarie, përcaktohen më tej me akt nënligjor të Komisionerit, duke respektuar parimet e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale siç përcaktohet në nenin 6, si dhe masën e kufizimeve për ushtrimin e të drejtave nga subjektet e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 28.

Neni 16

Përpunimi i të dhënave personale për qëllime arkivimi për interes publik, për qëllime historike ose kërkimore shkencore apo për qëllime statistikore

1. Përpunimi i të dhënave personale, përfshirë të dhënat sensitive dhe penale, për qëllime arkivimi për interes publik, qëllime historike ose kërkimore shkencore ose qëllime statistikore, përbën interes të ligjshëm të kontrolluesit, në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për sa kohë nuk marrin përparësi interesat ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave, të cilat kërkojnë mbrojtje të të dhënave të tyre personale. Për këtë qëllim, zbatohet paragrafi 3.

2. Të dhënat personale, përfshirë të dhënat sensitive dhe penale, të mbledhura për cilindo qëllim, mund të përpunohen më tej për qëllime arkivimi për interes publik, për qëllime historike, kërkimore shkencore ose qëllime statistikore, sipas kriterëve të posaçme të përcaktuara në paragrafin 3.

3. Përpunimi sipas paragrafit 1, si dhe përpunimi i mëtejshëm sipas paragrafit 2, kërkon marrjen e masave të përshtatshme mbrojtëse për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave. Këto masa mbrojtëse përfshijnë, sa më poshtë:

- a) masa teknike dhe organizative të ndërmarra nga kontrolluesi, të cilat sigurojnë veçanërisht, respektimin e parimit të minimizimit të të dhënave, si për shembull duke i anonimizuar ato. Këto masa mund të përfshijnë edhe pseudonimizimin e të dhënave, me kusht që në atë mënyrë të mund të përmbushet qëllimi i përpunimit. Kur qëllimet sipas këtij neni mund të përmbushen duke përpunuar të dhëna të anonimizuar, ose të paktën të pseudonimizuar, qëllimi do të përmbushet në këtë mënyrë;
- b) përpunimi i mëtejshëm nga kontrollues, të cilëve të dhënat nuk u janë besuar nga subjektet e të dhënave për një qëllim tjetër, kërkon anonimizim ose të paktën pseudonimizim të të

dhënave sipas pikës a), përpara se të kryhet transferimi i të dhënave për qëllime përpunimi të mëtejshëm;

- c) të dhënat personale sensitive, sidomos të dhënat shëndetësore, përpunohen vetëm nga persona që i nënshtrohen sekretit profesional ose një detyrimi ligjor të posaçëm për ruajtjen e konfidencialitetit;
- d) si masë mbrojtje e veçantë, të dhënat e mbledhura për përpunim ose përpunim të mëtejshëm sipas paragrafëve 1 ose 2, nuk përpunohen për marrjen e masave ose vendimeve në lidhje me subjektin e të dhënave, përveç nëse subjekti i të dhënave ka dhënë qartë pëlqimin e tij.

4. Përjashtimet nga ushtrimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave në lidhje me proceset e përpunimit për qëllimet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 zbatohen në rastet kur ushtrimi i një të drejte mund ta dëmtojë seriozisht ose të bëjë të pamundur realizimin e qëllimeve specifike, dhe këto përjashtime janë të nevojshme për përmbushjen e atyre qëllimeve. Kontrolluesi ka barrën për të provuar shkallën e vështirësisë së pengesave në arritjen e qëllimit të procesit të përpunimit që do të shkaktohej nga ushtrimi i të drejtave të një subjekti të të dhënave.

Neni 17

Përpunimi i të dhënave personale dhe aksesit i informacionit në sektorin publik

1. E drejta për mbrojtjen e të dhënave të individëve nuk cenon të drejtën e aksesit të publikut në dokumente zyrtare, të mbajtura nga një autoritet ose organ publik ose një subjekt privat për kryerjen e një funksioni me interes publik, si dhe aksesin e publikut në informacione për një individ, që kanë lidhje me kryerjen e funksioneve dhe detyrave zyrtare, në përputhje me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e jetës ose e drejta e integritetit fizik dhe mendor, kërkojnë mbrojtje të të dhënave të individëve, për një rast specifik ose kategori specifike rastesh.

2. E drejta për mbrojtjen e të dhënave të personave të tjerë, të ndryshëm nga ata të përmendur në paragrafin 1, respektohet sipas ligjit, kur jepet ose fitohet akses në dokumente zyrtare ose në informacion publik.

Neni 18

Përpunimi i të dhënave për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë

1. Marketingu i drejtpërdrejtë është komunikimi me persona drejtpërdrejtë të identifikueshëm, që supozohet se kanë një profil të caktuar interesi, me qëllim promovimin e mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë reklamimin e anëtarësimit në organizata (tregtare ose jofitimprurëse) si dhe kërkimin e donacioneve. Përveç kësaj, aktivitetet e marketingut të drejtpërdrejtë përfshijnë çdo akt përgatitor nga reklamuesi ose nga një palë e tretë për ta mundësuar këtë komunikim.

2. Përpunimi i të dhënave personale për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1 duhet të plotësojë të gjitha kriteret për përpunim të ligjshëm, sipas këtij ligji. Përpunimi për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, që ndiqet nga kontrolluesi ose nga palë të treta, mund të bazohet në interesin legjitim, në kuptim të gërmës f) të paragrafit 1 të nenit 7, për aq sa nuk cenohen interesa parësorë për mbrojtjen e subjekteve të të dhënave. Kjo zbatohet edhe për përdorimin e të dhënave të marra nga regjistra publikë për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë.

3. Përpunimi i të dhënave sensitive për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë kërkon marrjen e pëlqimit të shprehur nga subjekti i të dhënave.

4. Me qëllim mbrojtjen e interesave të subjekteve të të dhënave, krijohet "Regjistri i Komunikimeve Tregtare të Pakërkuara", rregullat për funksionimin e të cilit përcaktohen me ligj të veçantë.

5. Kur të dhënat personale përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave gëzon të drejtën ta kundërshtojë këtë përpunim në çdo moment, në përputhje me dispozitat e veçanta të paragrafit 2 të nenit 26.

KAPITULLI II

Të drejtat e subjektit të të dhënave

Seksioni 1

Komunikimi me subjektet e të dhënave

Neni 19

Komunikimi me subjektin e të dhënave dhe mënyrat e ushtrimit të të drejtave nga subjekti i të dhënave

1. Kontrolluesi, për aq sa është e mundur, lehtëson ushtrimin e të drejtave nga subjektet e të dhënave sipas neneve 20 deri te 27, duke vendosur një ekuilibër të drejtë midis interesave të subjekteve të të dhënave dhe barrës që përfaqësojnë për kontrolluesin detyrimet sipas këtyre neneve.

2. Komunikimi i kontrolluesit me një subjekt të të dhënave, sa i përket përpunimit të të dhënave të tij, zhvillohet në formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, veçanërisht sa i takon informacionit që i drejtohet në mënyrë specifike, një të mituri. Informacionet ofrohen me shkrim, kur është e përshtatshme me mjete elektronike, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave e paraqet kërkesën në formë elektronike. Kur kërkohet nga subjekti i të dhënave, informacioni mund të ofrohet në një formë tjetër, përfshirë formën verbale, duke zbatuar paragrafin 3.

3. Kur kontrolluesi ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit, i cili paraqet kërkesë në kuptim të neneve 20 deri 27, kontrolluesi kërkon informacion shtesë, me qëllim verifikimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

4. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave në lidhje me përmbushjen e kërkesës, ose arsyen e refuzimit të saj, pa vonesa të paarsyeshme dhe në çdo rast, brenda një muaji nga marrja e kërkesës. Kjo periudhë mund të zgjatet me dy muaj të tjerë kur është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave të marra. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave për çdo zgjatje afati, brenda një muaji nga marrja e kërkesës, duke dhënë arsyet për vonesën. Në rast refuzimi të përmbushjes së kërkesës, përgjigja përmban informacion lidhur me të drejtën e paraqitjes së ankesës tek Komisioneri.

5. Kur të dhënat janë pseudonimizuar, të drejtat sipas neneve 20 deri te 27 nuk mund të ushtrohen, nëse kontrolluesi provon se nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave.

6. Përgjigja ndaj kërkesës së një subjekti të të dhënave sipas neneve 20 deri te 27 ofrohet falas. Kur kërkesat nga një subjekt i të dhënave janë qartazi të pabazuara ose të paarsyeshme, sidomos për shkak të karakterit të tyre të përsëritur, kontrolluesi mund të:

- a) vendosë një tarifë të arsyeshme, duke marrë parasysh kostot administrative për ofrimin e informacionit ose komunikimit ose për të ndërmarrë veprimin e kërkuar; ose
- b) refuzojë ndërmarrjen e veprimeve për kërkesën.

Kontrolluesi ka barrën për të provuar natyrën qartësisht të pabazuar ose të paarsyeshme të kërkesës.

Seksioni 2 Të drejtat

Neni 20 E drejta për informim

1. Kur të dhënat personale janë marrë me bashkëpunimin e subjektit të të dhënave, dhe subjekti i të dhënave nuk e ka informacionin e përmendur më poshtë, atij duhet t'i jepet informacioni si më poshtë:

- a) identiteti dhe të dhënat e kontaktit të kontrolluesit dhe, kur është e zbatueshme, të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave të kontrolluesit;
- b) qëllimi(et) e përpunimit, duke përfshirë ekzistencën dhe logjikën e vendimmarrjes dhe profilizimit automatik;
- c) periudha e parashikuar e mbajtjes së të dhënave personale ose, nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për ta përcaktuar këtë periudhë;
- d) baza ligjore e përpunimit; kur baza ligjore është pëlqimi: mundësia për ta tërhequr këtë pëlqim; kur baza ligjore është interesi legjitim: interesi legjitim që ka për qëllim të realizojë përpunimi;
- e) detyrimin e subjektit të të dhënave të japë të dhënat personale dhe pasojat e mundshme nga mosdhënia e këtyre të dhënave;
- f) kategoritë e marrësve ose, kur mund të paraqiten rreziqe të veçanta për subjektet e të dhënave, marrësit e të dhënave të përpunuara, përfshirë informacionin nëse të dhënat do të transferohen në vende të huaja dhe nëse po, si garantohet mbrojtja e duhur;
- g) më tej, ushtrimin e të drejtave sipas neneve 21 deri te 27, dhe të drejtën për të paraqitur ankesë tek Komisioneri.

2. Kur të dhënat personale nuk janë marrë me bashkëpunimin e subjektit të të dhënave, duhet të jepet informacioni sipas paragrafit 1 dhe gjithashtu kategoritë e të dhënave personale që do të përpunohen, burimi i të dhënave personale, dhe, nëse është e zbatueshme, nëse ato janë marrë nga regjistra publikë, përveç kur:

- a) ofrimi i këtij informacioni rezulton i pamundur ose do të përbënte një përpjekje jo të arsyeshme dhe kontrolluesi ka marrë masat e duhura për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshëm të subjektit të të dhënave, ose

b) marrja e të dhënave nga burime të tjera përveç subjektit të të dhënave përcaktohet shprehimisht me ligj, ose

c) dhënia e informacionit nuk lejohet për shkak të një detyrimi për sekret profesional sipas ligjit.

3. Sa i përket afatit për dhënien e informacionit,

a) në rastin e cituar në paragrafin 1, informacioni duhet të jepet para se subjekti i të dhënave të ofrojë të dhënat;

b) në rastin e cituar në paragrafin 2, informacioni duhet të jepet

(i) jo më vonë se një muaj pasi të jenë marrë të dhënat, ose,

(ii) nëse të dhënat personale do të përdoren për komunikim me subjektin e të dhënave, jo më vonë se momenti i komunikimit të parë me subjektin e të dhënave; ose,

(iii) kur parashikohet përhapja tek një marrës tjetër, jo më vonë se momenti kur të dhënat personale janë përhapur për herë të parë.

4. Kur kontrolluesi synon të përpunojë më tej të dhënat personale, për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin ato janë mbledhur, dhe subjekti i të dhënave nuk e ka informacionin e duhur, kontrolluesi i ofron subjektit të të dhënave, përpara këtij përpunimi të mëtejshëm, informacion për këtë qëllim përpunimi, së bashku me çdo informacion shtesë të nevojshëm, siç përcaktohet në paragrafin 2. Përjashtimet e renditura në pikat (a) deri (c) të paragrafit 2 janë të zbatueshme edhe në këtë rast.

5. Detyrimi për të informuar sipas këtij neni mund të kryhet nga përpunuesi për llogari të kontrolluesit, nëse udhëzimet kanë qenë të tilla, me kusht që informacioni të japë qartë kush është kontrolluesi dhe si mund të kontaktohet ai.

Neni 21

E drejta për akses

Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të marrë nga kontrolluesi, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, një konfirmim nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar apo jo, si dhe, kur është rasti, të ketë akses në të dhënat personale dhe informacionin e mëposhtëm:

a) qëllimin(et) e përpunimit, duke përfshirë ekzistencën dhe logjikën e vendimmarrjes dhe profilizimit automatik;

b) afatin e parashikuar të ruajtjes së të dhënave personale ose, nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për ta përcaktuar këtë afat;

c) bazën ligjore të përpunimit;

d) kategoritë e të dhënave personale në fjalë, duke përfshirë, në rastet kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave, çdo informacion të disponueshëm për burimin e këtyre të dhënave;

e) kategoritë e marrësve ose, kur mund të paraqiten rreziqe të veçanta për subjektet e të dhënave, marrësit e të dhënave të përpunuara, përfshirë nëse të dhënat transferohen në vende të huaja dhe nëse po, si sigurohet mbrojtja e duhur;

f) ushtrimin e të drejtave sipas neneve 22 deri te 27, dhe të drejtën për të paraqitur ankesë tek Komisioneri.

2. Kontrolluesi i ofron falas subjektit të të dhënave, një kopje të listës së kategorive të të dhënave të përpunuara, duke treguar përmbajtjen e secilës kategori që lidhet me subjektin e të dhënave. Ky informacion nuk cenon të drejtat dhe liritë e personave të tjerë. Për çdo kopje të mëvonshme të kërkuar nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi mund të aplikojë një tarifë të arsyeshme në bazë të kostove administrative. Kur subjekti i të dhënave e bën kërkesën me mjete elektronike, dhe nëse nuk kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave, informacioni ofrohet në formën elektronike të përdorur zakonisht.

Neni 22

E drejta për korrigjim dhe fshirje

1. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën e korrigjimit nga kontrolluesi, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës, të të dhënave të pasakta personale që lidhen me të. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, subjekti i të dhënave gëzon të drejtën e plotësimit të dhënave personale jo të plota, edhe me anë të një deklaratë plotësuese.

2. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën e fshirjes nga kontrolluesi të të dhënave personale që lidhen me të, dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës, kur të dhënat përpunohen në mënyrë të paligjshme.

3. Përpunimi i të dhënave, nuk konsiderohet i paligjshëm kur:

- a) është i nevojshëm dhe proporcional me ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes sipas nenit 15, ose të së drejtës për akses të publikut në dokumente zyrtare dhe në informacione të sektorit publik sipas nenit 17, ose
- c) kryhet për qëllime arkivimi në interesin publik, për qëllime kërkimore shkencore ose historike, ose për qëllime statistikore dhe zbatohet paragrafi 4 i nenit 16, ose
- b) është i nevojshëm për arsye të interesit publik në fushën e shëndetit publik në përputhje me pikat (h) dhe (i) të nenit 9, ose
- d) është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

4. Kur të dhënat korrigjohen ose fshihen, kontrolluesi informon të gjithë marrësit të cilëve ua ka përhapur ato të dhëna. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave rreth këtyre marrësve, nëse dicka e tillë kërkohet nga subjekti i të dhënave. Këto detyrime të kontrolluesit nuk gjejnë zbatim, vetëm në ato raste kur përmbushja e tyre është e pamundur ose do të kërkonte përpjekje të paarsyeshme.

Neni 23

E drejta për t'u harruar

1. Kur kontrolluesi ka bërë publike të dhëna personale dhe detyrohet, në përputhje me nenin 22, t'i fshijë ato, kontrolluesi, duke marrë parasysh teknologjinë e zbatueshme dhe koston e zbatimit, ndërmerr hapa të arsyeshëm, përfshirë masat teknike, për të informuar kontrolluesit që janë duke përpunuar këto të dhëna personale, që subjekti i të dhënave ka kërkuar fshirjen e çdo lidhjeje (linku), ose kopjeje ose replikimi të këtyre të dhënave personale.

2. Operatorët e motorëve të kërkimit në internet janë të detyruar, me kërkesë të subjektit të të dhënave, të fshijnë nga rezultatet, që shfaqen pas një kërkimi të kryer në bazë të emrit të subjektit të të dhënave, informacionin, i cili nuk është më aktual me kalimin e kohës por që, kur gjendet, ka një ndikim negativ të konsiderueshëm në reputacionin e subjektit të të dhënave.

Neni 24

E drejta për të bllokuar përpunimin

1. Kur saktësia ose ligjshmëria e përpunimit kundërshtohet nga subjekti i të dhënave, ai gëzon të drejtën t'i kërkojë kontrolluesit bllokimin e përpunimit, derisa për çështjen në fjalë të merret një vendim nga autoritetet kompetente. Nëse kontrolluesi refuzon kërkesën, subjekti i të dhënave mund të paraqesë ankesë tek Komisioneri dhe të kërkojë marrjen e një vendimi paraprak për bllokimin e përpunimit; Komisioneri lëshon urdhër paraprak bllokimi sipas nenit 90 jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e kërkesës, nëse kjo është e nevojshme dhe proporcionale.
2. Bllokimi i përpunimit nënkupton që të dhënat personale, me përjashtim të ruajtjes, përpunohen vetëm pas marrjes së pëlqimit të subjektit të të dhënave, për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore, për mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër fizik ose juridik të cilat kanë përparësi mbi të drejtat e subjektit të të dhënave ose për interes të rëndësishëm publik.
3. Kur të dhënat bllokohen, kontrolluesi informon të gjithë marrësit të cilëve ua ka përhapur të dhënat në fjalë përpara bllokimit.

Neni 25

E drejta për transferueshmërinë e të dhënave

1. Kur të dhënat i jepen një kontrolluesi nga subjekti i të dhënave, mbi bazë pëlqimi ose kontrate, për shkak se subjekti i të dhënave dëshiron që këto të dhëna të përpunohen për një qëllim specifik, subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të marrë nga kontrolluesi rezultatin e përpunimit të të dhënave të ofruara. Për sa i përket përpunimit të kryer me mjete automatike, rezultati i përpunimit jepet në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm nga pajisjet. Me kërkesë të veçantë nga subjekti i të dhënave dhe kur është e mundur nga pikëpamja teknike, kontrolluesi transmeton rezultatin e përpunimit, drejtpërdrejtë tek një kontrollues tjetër.
2. Kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet kur përpunimi i të dhënave është i nevojshëm për kryerjen e një detyre, e cila i është caktuar kontrolluesit me ligj dhe kryhet në interes të publikut dhe/ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar.
3. E drejta e përmendur në paragrafin 1 nuk mund të çënojë të drejtat dhe liritë e personave të tjerë.

Neni 26

E drejta për të kundërshtuar

1. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të kundërshtojë në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën e tij të veçantë, përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, në bazë të gërmave (e) dhe (f) të nenit 7, përfshirë profilizimin bazuar në ato dispozita. Kjo vlen përkatësisht për përpunimin e të dhënave sensitive ose penale.

2. Kur të dhënat personale përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të kundërshtojë në çdo kohë, pa pasur nevojë të japë ndonjë arsye, përpunimin e të dhënave të tij personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, që përfshin profilizimin për aq sa është i lidhur me këtë marketing të drejtpërdrejtë.

3. E drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e përmendura në nenin 16 kufizohet në ato veprime përpunimi, të cilat nuk janë të nevojshme për kryerjen e një detyre me interes publik.

4. Në vijim të një kundërshtimi sipas paragrafëve 1 deri në 3, kontrolluesi nuk përpunon më të dhëna personale, përveç nëse tregon arsye të forta legjitime për përpunimin, të cilat kanë përparësi mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave, veçanërisht kur kanë të bëjnë me ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

Neni 27

E drejta për të mos iu nënshtuar vendimeve automatike

1. Subjekti i të dhënave gëzon të drejtën të mos i nënshtrohet një vendimi që bazohet vetëm në përpunimin automatik, duke përfshirë profilizimin, i cili shkakton pasoja ligjore ose pasoja të ngjashme të konsiderueshme mbi të.

2. Përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj, paragrafi 1 nuk zbatohet, nëse vendimi:

- a) është i nevojshëm për lidhjen ose zbatimin e një kontrate midis subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit, ose,
- b) bazohet në pëlqimin e dhënë nga subjekti të cilit i përkasin të dhënat.

3. Përpunimi i të dhënave sensitive për vendimet automatike kërkon pëlqimin e shprehur qartë nga subjekti i të dhënave ose duhet të bazohet në një dispozitë ligjore në përputhje me gërmën g) të paragrafit 2 të nenit 9.

4. Në rastet e përmendura në paragrafët 2 dhe 3, kontrolluesi i të dhënave vë në zbatim masa të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave, të drejtën e subjektit të të dhënave për ndërhyrje manuale nga ana e kontrolluesit, për të shprehur këndvështrimin e tij dhe për të kundërshtuar vendimin.

Seksioni 3 **Kufizimet**

Neni 28

Kufizimet e të drejtave të subjekteve të të dhënave

Fusha e zbatimit të të drejtave të parashikuara në nenet 20 deri 27 dhe të detyrimeve që burojnë për kontrolluesit, si dhe neni 6, për aq sa dispozitat e tij korrespondojnë me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenet 20 deri në 27, mund të kufizohen me ligj, nëse është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave ose veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirisë së personave të tjerë.

KREU IV ***Detyrimet e kontrolluesit dhe të përpunuesit***

Seksioni 1 **Përgjegjësia**

Neni 29 **Përgjegjësia e përgjithshme e kontrolluesit**

1. Duke marrë parasysh natyrën, fushën e zbatimit, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe mundësinë e shfaqjes dhe përshkallëzimit të rrezikut për të drejtat dhe liritë e individëve, kontrolluesi zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar dhe për të qenë i aftë të demonstrojë që përpunimi është kryer në përputhje me këtë ligj. Këto masa rishikohen dhe përditësohen sipas nevojës.
2. Kontrolluesi reflekton mbi mënyrën e vënies në zbatim të konceptit të privatësisë në projektim (*privacy by design*) në përputhje me nenin 41 në proceset e tij përpunuese dhe se si mund të administrohet koncepti i privatësisë në mënyrë të paracaktuar (*privacy by default*) në përputhje me këtë nen. Gjithashtu, emërimi i një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave merret në konsideratë pavarësisht kriterëve të përcaktuara në nenin 43, veçanërisht kur proceset e përpunimit të kontrolluesit përmbajnë elemente të tjerë të rëndësishëm rreziku, përveç atyre të përmendur në paragrafin 1 të nenit 43.
3. Aderimi në kodet e miratuara të sjelljes siç përmendet në nenin 44 ose vënia në zbatim e një mekanizmi të miratuar certifikimi siç përmendet në nenin 46 mund të përdoret si një element për të treguar përputhshmërinë me detyrimet e kontrolluesit.
4. Kontrolluesit janë të detyruar të bashkëpunojnë, kur kërkohet nga Komisioneri, në funksion të kryerjes së kryerjen e detyrave të tij.

Neni 30 **Kontrollues të përbashkët**

1. Kur dy ose më shumë kontrollues përcaktojnë së bashku qëllimet dhe mjetet e përpunimit, ata quhen kontrollues të përbashkët. Ata hartojnë me shkrim një marrëveshje për përgjegjësitë e tyre përkatëse në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, veçanërisht sa i takon ushtrimin të të drejtave të subjektit të të dhënave dhe detyrave përkatëse të kontrolluesve në përputhje me Kapitullin II.

2. Thelbi i marrëveshjes, i përmendur në paragrafin 1, iu vihet në dispozicion subjekteve të të dhënave.

3. Marrëveshja e përmendur në paragrafin 1, mund të përcaktojë një pikë kontakti për subjektet e të dhënave. Megjithatë, pavarësisht nga kushtet e marrëveshjes, subjekti i të dhënave mund të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij ligji kundrejt secilit kontrollues.

Neni 31

Marrëdhënia midis kontrolluesit dhe përpunuesit

1. Kur përpunimi duhet të kryhet për llogari të një kontrolluesi, kontrolluesi përdor vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative në mënyrë që përpunimi t'i përgjigjet kërkesave të këtij ligji dhe të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave.

2. Përpunuesi nuk angazhon përpunues tjetër pa autorizimin paraprak specifik ose të përgjithshëm me shkrim të kontrolluesit. Në rastin e një autorizimi të përgjithshëm me shkrim, përpunuesi informon kontrolluesin për çdo ndryshim të synuar në lidhje me shtimin ose zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kështu kontrolluesit mundësinë e kundërshtimit të këtyre ndryshimeve.

3. Përpunimi nga një përpunues rregullohet me kontratë, me shkrim, ose me një instrument tjetër të përshtatshëm ligjor, i cili është detyrues për përpunuesin në lidhje me kontrolluesin, dhe që përcakton objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, llojin e të dhënave personale dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave si dhe detyrimet dhe të drejtat e kontrolluesit. Kjo kontratë ose instrument tjetër i përshtatshëm ligjor përcakton, në veçanti, që përpunuesi:

- a) përpunon dhe, në veçanti, transferon të dhëna personale vetëm sipas udhëzimeve të dokumentuara të kontrolluesit, përveç nëse kërkohet ta bëjë këtë me ligj, rast në të cilin përpunuesi informon kontrolluesin për këtë kërkesë ligjore para përpunimit, përveç nëse ligji ndalon këto informacione për arsye të rëndësishme interesi publik. Nëse, nga ana tjetër, në opinionin e përpunuesit, udhëzimi shkel këtë ligj, përpunuesi informon menjëherë kontrolluesin dhe e dokumenton atë;
- b) siguron që personat e autorizuar për të përpunuar të dhënat personale i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit siç parashikohet nga neni 33 dhe rregullat e tjera profesionale;
- c) merr të gjitha masat e përcaktuara sipas nenit 32;
- d) respekton kushtet e përmendura në paragrafët 2 dhe 4 për angazhimin e një përpunuesi tjetër;
- e) duke marrë parasysh natyrën e përpunimit, asiston kontrolluesin me masa të përshtatshme teknike dhe organizative, për aq sa kjo është e mundur, për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit për t'iu përgjigjur kërkesave në ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave të përcaktuara në Kapitullin II;
- f) asiston kontrolluesin për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli IV, në veçanti nga nenet 32 dhe 34, duke marrë parasysh natyrën e përpunimit dhe informacionin në dispozicion të përpunuesit;

- g) në përputhje me vullnetin e kontrolluesit, fshin ose kthen të gjitha të dhënat personale tek kontrolluesi pas përfundimit të ofrimit të shërbimeve të lidhura me përpunimin, dhe fshin kopjet ekzistuese nëse ruajtja e të dhënave personale nuk kërkohet me ligj;
- h) vë në dispozicion të kontrolluesit të gjitha informacionet e nevojshme për të demonstruar përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen, si dhe lejon dhe kontribuon në kryerjen e auditimeve, përfshirë inspektimet, nga kontrolluesi ose një auditues tjetër, i autorizuar nga kontrolluesi.
4. Kur përpunuesi angazhon një përpunues tjetër për kryerjen e veprimeve specifike të përpunimit për llogari të kontrolluesit, të njëjtat detyrime për mbrojtjen e të dhënave, siç përcaktohen në paragrafin 3, i ngarkohen atij përpunuesi përmes një kontrate ose instrumenti tjetër të përshtatshëm ligjor që ofron garanci të mjaftueshme që përpunimi do të përmbushë kërkesat e këtij ligji. Kur përpunuesi tjetër nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij për mbrojtjen e të dhënave, përpunuesi fillestar mbetet tërësisht përgjegjës ndaj kontrolluesit për përmbushjen e detyrimeve të përpunuesit tjetër.
5. Aderimi nga një përpunues në kodin e miratuar të sjelljes siç përmendet në nenin 44 ose zbatimi i një mekanizmi të miratuar certifikimi siç përmendet në nenin 46 mund të shërbejë si një element për të treguar garanci të mjaftueshme në përputhje me paragrafët 1 dhe 4 të këtij neni.
6. Pa cenuar kontratën individuale ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, kontrata mund të bazohet, tërësisht ose pjesërisht, në klauzola standarde kontraktuale të përmendura në paragrafin 7 të këtij neni, përfshirë edhe kur ato janë pjesë e një certifikimi të dhënë kontrolluesit ose përpunuesit në përputhje me nenet 46 dhe 47.
7. Komisioneri mund të përcaktojë dhe publikojë klauzola standarde kontraktuale për çështjet e përmendura në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni.
8. Nëse përpunuesi shkel dispozitat e këtij neni duke përcaktuar qëllimet dhe mjetet e përpunimit, përpunuesi konsiderohet si kontrollues në lidhje me këtë përpunim.

Seksioni 2 Siguria e përpunimit

Neni 32

Masat për të garantuar sigurinë e përpunimit

1. Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, kostot e zbatimit dhe natyrën, fushën e zbatimit, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe mundësinë e shfaqjes dhe përshkallëzimit të rrezikut për të drejtat dhe liritë e individëve, kontrolluesi dhe përpunuesi zbatojnë masat e

duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke përfshirë, ndër të tjera, kur është e zbatueshme:

- a) pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale;
- b) aftësinë për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;
- c) aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik;
- d) një proces për testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit.

2. Në vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të sigurisë, merren parasysh veçanërisht rreziqet që shkaktohen nga përpunimi, specifikisht, nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm, humbja, ndryshimi, përhapja e paautorizuar ose aksesin në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në çfarëdolloj mënyre.

3. Aderimi në kodet e miratuara të sjelljes të përmendura në nenin 44 ose zbatimi i një mekanizmi të miratuar certifikimi sipas nenit 46 mund të përdoret si një element për të demonstruar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Kontrolluesi dhe përpunuesi marrin masa për të siguruar që çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose përpunuesit, i cili ka akses në të dhënat personale, të mos i përpunojë ato përveçse sipas udhëzimeve nga kontrolluesi, me përjashtim të rasteve kur këtij personi i kërkohet ta bëjë këtë me ligj.

Neni 33

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Çdo person, si kontrollues, përpunues ose punonjës i një kontrolluesi ose përpunuesi, mban sekret të dhënat personale, tek të cilat ka pasur akses për arsye profesionale, dhe ua zbulon ato të tretëve vetëm sipas ligjit, në veçanti sipas paragrafit 2. Ky detyrim është gjithashtu pjesë e çdo kontrate me një përpunues sipas nenit 31, dhe e të gjitha kontratave të punës së një kontrolluesi ose përpunuesi.

2. Përpunuesit e angazhuar nga kontrolluesi, dhe çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose përpunuesit, i cili ka akses në të dhënat personale, i përpunon ato të dhëna vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit apo përpunuesit të angazhuar prej kontrolluesit, me përjashtim të rasteve kur përpunimi kërkohet me ligj specifik. Kontrolluesit dhe përpunuesit përcakojnë rregulla me shkrim në lidhje me kompetencën për të dhënë udhëzime për përpunim. Këto rregulla duhet të sillen në vëmendjen e të gjithë personave të interesuar.

3. Detyrimi për të mbajtur të dhënat konfidenciale në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 vijon përtej afatit të kontratës ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, dhe përtej ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me kontrolluesin ose përpunuesin.

Neni 34

Cenimi i të dhënave personale

1. Kur një cenim i sigurisë çon në shkatërrimin aksidental ose të paligjshëm, humbjen, ndryshimin, zbulimin e paautorizuar të të dhënave personale ose në aksesin e paautorizuar në të dhënat personale, kontrolluesi, njofton pa vonesa Komisionerin, dhe kur është e mundur, jo më vonë se 72 orë pasi të jetë vendosur në dijeni për këtë cenim, përveç nëse nuk ka gjasa që cenimi i të dhënave të rrezikojë të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave. Kur njoftimi i autoritetit mbikëqyrës nuk kryhet brenda 72 orësh, ai shoqërohet me arsyet e vonesës.
2. Përpunuesi njofton kontrolluesin menjëherë pasi të jetë vendosur në dijeni për cenimin e të dhënave.
3. Gjithashtu, kontrolluesi informon subjektet e të dhënave, kur rreziqet e shkaktuara nga cenimi i të dhënave ndaj të drejtave dhe lirive të tyre ka të ngjarë të jenë të larta dhe kur kontrolluesi konstaton se masat teknike ose organizative nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme. Sa i përket përmbajtjes së informacionit, zbatohet paragrafi 4.
4. Njoftimi për Komisionerin, sipas paragrafit 1, duhet që të paktën:
 - a) të përshkruajë natyrën e cenimit të të dhënave duke përfshirë, kur është e mundur, kategoritë dhe numrin e përafërt të subjekteve të të dhënave në fjalë si dhe kategoritë dhe numrin e përafërt të llogarive të të dhënave personale në fjalë;
 - b) të komunikojë emrin dhe të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave ose pikës tjetër të kontaktit ku mund të merren më shumë informacione;
 - c) të përshkruajë pasojat e mundshme të cenimit të të dhënave personale;
 - d) të përshkruajë masat e marra ose të propozuara për t'u marrë nga kontrolluesi për të trajtuar cenimin e të dhënave personale, duke përfshirë, sipas rastit, masat për të zbutur efektet e mundshme negative të tij.
5. Kur dhe për aq kohë sa nuk është e mundur të sigurohet informacioni në të njëjtën kohë, ai mund të jepet në vijim pa vonesa të mëtejshme të paarsyeshme.
6. Kontrolluesi dokumenton çdo cenim të të dhënave, duke përfshirë faktet, efektet e saj dhe masat korrigjuese të ndërmarra. Ky dokumentacion i mundëson Komisionerit të verifikojë përputhshmërinë me këtë nen.
7. Komisioneri i përgjigjet njoftimit në përputhje me kompetencat e tij sipas Pjesës IV të këtij Ligji. Ai mund të detyrojë kontrolluesin që t'u komunikojë gjithashtu subjekteve të të dhënave në fjalë cenimin e të dhënave, kur ka të ngjarë që cenimi i të dhënave të përbëjë një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e tyre dhe kur kontrolluesi nuk e ka kryer këtë komunikim.

Seksioni 3

Dokumentimi, vlerësimi i ndikimit dhe njoftimi

Neni 35

Detyrimi për të dokumentuar

1. Çdo kontrollues dhe përpunues mban dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese me qëllim që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë e tij me këtë ligj. Këto të dhëna janë në formë të shkruar, duke përfshirë formatin elektronik.

2. Të dhënat që duhet të mbahen nga kontrolluesit përmbajnë të gjitha informacionet e renditura në nenin 39.
3. Përpunuesit mbajnë të dhëna të kategorive të veprimtarive të përpunimit që ato kryejnë për llogari të një kontrolluesi, që përmbajnë:
 - a) emrin dhe të dhënat e kontaktit të përpunuesit dhe kur është e zbatueshme, të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave;
 - b) emrin dhe të dhënat e kontaktit të çdo kontrolluesi për llogari të të cilit vepron përpunuesi;
 - c) emrat dhe të dhënat e kontaktit të nën-përpunuesve të angazhuar për detyra të caktuara;
 - d) një përshkrim të kategorive të veprimtarive të përpunimit, të kryera për llogari të çdo kontrolluesi;
 - e) kur është e zbatueshme, transferimet e të dhënave personale në një vend të tretë ose në një organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë identifikimin e atij vendi të tretë ose të asaj organizate ndërkombëtare, si dhe bazën ligjore në përputhje me nenet 12 deri 14 për këtë transferim;
 - f) nëse është e mundur, një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative të sigurisë të zbatuara në ambientet e përpunuesit.
4. Kontrolluesi ose përpunuesi vendos të dhënat në dispozicion të Komisionerit sipas kërkesës.

Neni 36

Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave

1. Pa cenuar detyrën për të dokumentuar veprimet e përpunimit sipas paragrafit 1 të nenit 35 dhe për t'i komunikuar ato sipas nenit 38, kontrolluesi, para se të fillojë përpunimin, kryen një vlerësim të ndikimit të veprimit të parashikuar të përpunimit, në mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo është veçanërisht e nevojshme kur një lloj përpunimi përdor teknologji të reja, ose, duke marrë parasysh natyrën, fushën e zbatimit, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, ka të ngjarë që përpunimi të përbëjë një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave. Një vlerësim i vetëm mund të mbulojë një sërë veprimesh të ngjashme përpunimi që paraqesin rreziqe të larta të ngjashme.
2. Kur kontrolluesi kryen disa veprime të caktuara përpunimi që kërkohen me ligj, i cili përcakton gjithashtu të dhëna për veprimet e përpunimit në fjalë dhe kur është kryer një vlerësim i ndikimit në kuadër të miratimit të këtij ligji, nuk është i nevojshëm një vlerësim i mëtejshëm i ndikimit.
3. Vlerësimi i ndikimit përmban të paktën:
 - a) një përshkrim sistematik të veprimeve të parashikuara të përpunimit dhe qëllimeve të përpunimit, duke përfshirë, sipas rastit, llojin e interesit legjitim të kontrolluesit;
 - b) një vlerësim të nevojës dhe proporcionalitetit të veprimeve të përpunimit në lidhje me qëllimet;
 - c) një vlerësim të rreziqeve për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave të përmendura në paragrafin 1, dhe
 - d) masat e parashikuara për të trajtuar rreziqet, duke përfshirë masat mbrojtëse, masat dhe mekanizmat e sigurisë, për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të

demonstruar përputhshmërinë me këtë ligj, duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave dhe personave të tjerë të interesuar.

4. Kontrolluesi kërkon mendimin e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, kur ka një të tillë, në kuadër të kryerjes së një vlerësimi të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave.

5. Kur është e përshtatshme, kontrolluesi kërkon mendimin e subjekteve të të dhënave ose përfaqësuesve të tyre për përpunimin e synuar, pa cenuar mbrojtjen e interesave tregtare ose publike ose sigurinë e veprimeve të përpunimit.

6. Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale është veçanërisht i detyrueshëm në rastin e:

- a) një vlerësimi sistematik dhe të thelluar të aspekteve personale në lidhje me personat, i cili bazohet në përpunimin automatik, duke përfshirë profilizimin, dhe mbi të cilin bazohen vendime që prodhojnë pasoja ligjore ose pasoja të ngjashme të rëndësishme në lidhje me personin;
- b) përpunimit në një shkallë të gjerë të të dhënave sensitive siç përmendet në paragrafin 1 të nenit 9, ose të të dhënave penale të përmendura në nenin 10; ose
- c) një monitorimi sistematik të një zone të aksesueshme nga publiku në një shkallë të gjerë.

7. Komisioneri bën publik me vendim llojin e veprimeve të përpunimit që i nënshtrohen kërkesës së vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave sipas paragrafëve 1 dhe 3.

8. Gjithashtu, me vendim, Komisioneri mund të bëjë publike llojin e veprimeve të përpunimit për të cilat nuk kërkohet vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave.

9. Përputhshmëria me kodet e miratuara të sjelljes, siç përmendet në nenin 44, merret parasysh në vlerësimin e ndikimit të veprimeve të përpunimit të kryera nga një kontrollues.

10. Kur është e nevojshme, kontrolluesi rishikon vlerësimin e ndikimit për të vlerësuar nëse përpunimi është kryer në përputhje me vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur ka të paktën një ndryshim të rrezikut të përfaqësuar nga veprimet e përpunimit.

Neni 37

Konsultimi paraprak

1. Kontrolluesi konsultohet me Komisionerin para përpunimit, kur vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave sipas nenit 36 tregon që përpunimi do të përbënte rrezik të lartë në mungesë të masave që mund të merren nga kontrolluesi për të zbutur rrezikun.

2. Kur Komisioneri është i mendimit se përpunimi i synuar, i sjellë në vëmendje të tij, do të shkelte këtë Ligj, në veçanti, nëse kontrolluesi nuk ka identifikuar ose zbutur në mënyrë të mjaftueshme rreziqet, Komisioneri, brenda një periudhe deri në tetë javë nga marrja e kërkesës për konsultim, jep këshillim me shkrim për kontrolluesin dhe mund të ushtrojë kompetencat e tij sipas nenit 85. Kjo periudhë mund të zgjatet me gjashtë javë, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e përpunimit të synuar. Komisioneri informon kontrolluesin për zgjatjen e afatit brenda një muaji nga marrja e kërkesës për konsultim, si dhe për arsyet e vonesës. Këto periudha mund të pezullohen derisa Komisioneri të marrë informacionin që ka kërkuar për qëllimin e konsultimit.

3. Kur konsultohet me Komisionerin në përputhje me paragrafin 1, kontrolluesi i jep Komisionerit informacione, në veçanti për:

- a) kur është e zbatueshme, përgjegjësitë përkatëse të kontrolluesit, kontrolluesve të përbashkët dhe përpunuesve të përfshirë në përpunim, veçanërisht për përpunimin brenda një grupi ndërmarrjesh;
- b) qëllimet dhe mjetet e përpunimit të synuar;
- c) natyrën dhe efektet e rreziqeve të dyshuara;
- d) masat dhe garancitë e parashikuara për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj;
- e) kur është e zbatueshme, të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave.

4. Për veprimet e përpunimit ose llojet e këtyre veprimeve, të cilat ka të ngjarë të paraqesin një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, Komisioneri duhet të kontaktohet për konsultim paraprak dhe përpunimi lejohet vetëm nëse Komisioneri e autorizon atë.

Neni 38

Detyrimi për njoftim

1. Çdo kontrollues njofton Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Njoftimi bëhet për çdo qëllim të përpunimit dhe përpara se kontrolluesi të fillojë të përpunojë të dhënat, ose kur parashikohet një ndryshim në veprimet e përpunimit.

2. Kontrolluesit përjashtohen nga detyrimi për njoftim, sipas paragrafit 1, kur

- a) përpunimi kryhet për një regjistër, i cili sipas ligjit ose akteve nënligjore, ofron informacion për publikun në përgjithësi, ose,
- b) të dhënat përpunohen në interes të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomike ose financiare të shtetit, parandalimit ose ndjekjes së veprave penale, ose,
- c) në raste të tjera të përpunimit që janë deklaruar të përjashtuara nga detyrimi për njoftim me anë të një vendimi të publikuar nga Komisioneri.

Neni 39

Përmbajtja e njoftimit

Njoftimi përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e kontrolluesit dhe, sipas rastit, të kontrolluesit(ve) e përbashkët;
- b) adresën për komunikim të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave;
- c) qëllimin(et) e përpunimit të të dhënave personale;
- d) bazën ligjore/bazat e përpunimit;

- e) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale të përpunuara;
- f) kategoritë e marrësve të të dhënave personale, duke përfshirë marrësit në vendet e huaja ose organizatat ndërkombëtare;
- g) kur është e zbatueshme, transferimet e të dhënave personale në një vend të huaj ose në një organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë identifikimin e atij vendi të huaj ose asaj organizate ndërkombëtare;
- h) kur është e mundur, afatet e parashikuara kohore për ruajtjen e kategorive të ndryshme të të dhënave;
- i) një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 40

Regjistri i njoftimeve

1. Komisioneri mban regjistrin e njoftimeve të marra, i cili është i hapur për publikun, përveç informacionit të përcaktuar në shkronjën i) të nenit 39 të këtij ligji.
2. Para se të hidhet në regjistër, Komisioneri shqyrton njoftimin për plotësinë e tij, për të parë nëse informacioni është pasqyruar në çdo pikë të formularit të njoftimit. Kur njoftimi është i paplotë ose ka mangësi të dukshme, Komisioneri urdhëron kontrolluesin, duke përcaktuar një afat, për të plotësuar ose korrigjuar njoftimin. Nëse kontrolluesi nuk respekton afatin e caktuar, detyrimi për njoftim konsiderohet i papërbushur.
3. Sapo njoftimi të jetë pasqyruar në regjistër, kontrolluesi mund të fillojë përpunimin.

Seksioni 4

Instrumente të veçantë që ndihmojnë përputhshmërinë

Neni 41

Koncepti i mbrojtjes së të dhënave në projektim (*by design*) dhe mbrojtjes në mënyrë të paracaktuar (*by default*)

1. Kontrolluesi, që në momentin e përcaktimit të mjeteve të përpunimit ashtu edhe gjatë përpunimit, zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për integrimin e masave mbrojtëse të nevojshme në veprimet e tij të përpunimit, të tilla si pseudonimizimi ose minimizimi i të dhënave, në mënyrë që të plotësojë kërkesat e këtij ligji, veçanërisht të parimeve të përcaktuara në nenin 6, dhe për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave në mënyrën më të mirë të mundshme. Për këtë qëllim, kontrolluesi do të marrë parasysh zhvillimet teknologjike, kostot e zbatimit dhe natyrën, fushën e zbatimit, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe mundësinë e shfajës dhe përshkallëzimit të rreziqeve që paraqesin veprimet e përpunimit në lidhje me të drejtat dhe liritë e personave.
2. Kontrolluesi zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar që, në mënyrë të paracaktuar (*by default*), do të përpunohen vetëm të dhëna personale, të cilat janë të nevojshme për secilin qëllim specifik të përpunimit. Ky detyrim vlen për sasinë e të dhënave personale të mbledhura, për masën e përpunimit, për periudhën e ruajtjes dhe aksesueshmërinë

e tyre. Në veçanti, këto masa do të garantojnë që, në mënyrë të paracaktuar (*by default*), të dhënat personale nuk do të bëhen të aksesueshme për një numër të pacaktuar personash pa ndërhyrjen e subjektit të të dhënave.

3. Një mekanizëm i miratuar certifikimi në përputhje me nenin 46 mund të përdoret si një element për të demonstruar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 42

Detyrat dhe pozicioni i nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave

1. Kontrolluesit dhe përpunuesit emërojnë nëpunës të mbrojtjes së të dhënave për promovimin e përputhshmërisë me këtë ligj. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave:

- a) jep këshilla, kur kërkohet, për organet drejtues të kontrolluesit ose përpunuesit në të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave;
- b) merr pjesë në aktivitetet e vlerësimit të ndikimit sipas nenit 36;
- c) informon dhe këshillon stafin e kontrolluesit ose të përpunuesit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin e stafit të përfshirë në veprimet e përpunimit, dhe auditimet përkatëse;
- d) monitoron përputhshmërinë me këtë ligj dhe raporton tek stafi drejtues;
- e) bashkëpunon dhe shërben si pikë kontakti për Komisionerin.

2. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave caktohet në bazë të aftësive profesionale të certifikuara dhe në veçanti, në bazë të njohurive të mira të ligjit dhe praktikave të mbrojtjes së të dhënave, si dhe aftësisë për të përmbushur detyrat e përmendura në paragrafin 1. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave mund të jetë një anëtar i stafit të kontrolluesit ose përpunuesit, ose i kryen detyrat në bazë të një kontrate shërbimi. Ai mund të mbajë përgjegjësi dhe detyra të tjera, megjithatë, kontrolluesi ose përpunuesi siguron që këto përgjegjësi dhe detyra të mos shkaktojnë konflikt interesi.

3. Kontrolluesi ose përpunuesi publikon të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave si dhe ia komunikon ato Komisionerit. Subjektet e të dhënave mund të kontaktojnë nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre sipas këtij ligji.

4. Kontrolluesi dhe përpunuesi sigurojnë që nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave është i përfshirë, në mënyrë dhe në kohën e duhur, në të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe ka burimet e nevojshme për të përmbushur detyrat e tij. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave raporton drejtpërdrejtë para nivelit më të lartë drejtues të kontrolluesit ose përpunuesit. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së sekretit dhe konfidencialitetit në lidhje me kryerjen e detyrave të tij.

5. Kontrolluesi dhe përpunuesi sigurojnë që nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave nuk merr udhëzime në lidhje me ushtrimin e detyrave të tij. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave nuk shkarkohet ose penalizohet nga kontrolluesi ose përpunuesi për shkak të kryerjes së detyrave të tij.

6. Nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave mund të organizohen në kuadër të Dhomës Kombëtare të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave. Dhoma Kombëtare e Nëpunësve për Mbrojtjen e të

Dhënave krijohet dhe funksionon në formën e shoqatës, sipas parashikimeve të legjislacionit për organizatat jofitimprurëse. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj të brendshëm përcaktohen me udhëzim të Komisionerit.

Neni 43

Detyrimi për të emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave

1. Kontrolluesi dhe përpunuesi duhet të emërojë një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave kur:
 - a) përpunimi kryhet nga një autoritet ose organ publik, me përjashtim të gjykatave në kuadër të veprimtarisë gjyqësore;
 - b) aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose përpunuesit konsistojnë në veprime përpunimi të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit dhe/ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë; ose
 - c) aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose përpunuesit konsistojnë në përpunimin në një shkallë të gjerë të të dhënave sensitive në përputhje me nenin 9 ose të dhënave penale të përmendura në nenin 10.
2. Një grup ndërmarrjesh ose shoqatash dhe subjektsh të tjera, që përfaqësojnë kategori kontrolluesish ose përpunuesish, mund të emërojë një nëpunës të vetëm të mbrojtjes së të dhënave, me kusht që nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave të jetë lehtësisht i arritshëm nga secili subjekt.
3. Kur kontrolluesi ose përpunuesi është një autoritet ose organ publik, mund të caktohet një nëpunës i vetëm për disa prej këtyre autoriteteve ose organeve, duke marrë parasysh strukturën dhe përmasat e tyre organizative.

Neni 44

Kodet e sjelljes

1. Shoqatat dhe organet e tjera, që përfaqësojnë kategori ose degë të kontrolluesve ose përpunuesve, mund të hartojnë kode sjelljeje me qëllim specifikimin e zbatimit të këtij ligji, në lidhje, por jo vetëm, me:
 - a) përpunimin e drejtë dhe transparent;
 - b) interesat legjitimë të kontrolluesit në kontekste specifike;
 - c) mbledhjen e të dhënave personale;
 - d) pseudonimizimin e të dhënave personale;
 - e) informacionin e dhënë për publikun dhe subjektet e të dhënave;
 - f) ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave;
 - g) informacionin e dhënë, mbrojtjen e fëmijëve, dhe mënyrën në të cilën duhet të merret pëlqimi nga kujdestari ligjor i fëmijës;
 - h) masat dhe procedurat për të garantuar sigurinë e përpunimit dhe, veçanërisht, privatësinë në projektim (*by design*) dhe/ose atë në mënyrë të paracaktuar (*by default*);
 - i) njoftimin e autoriteteve mbikëqyrëse për cenimin e të dhënave personale;
 - j) transferimin e të dhënave personale në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare; ose

k) procedurat jashtë gjyqësore dhe procedurat e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave në lidhje me përpunimin, pa cenuar të drejtat e subjekteve të të dhënave për të paraqitur ankesë tek Komisioneri në përputhje me Pjesën V të këtij Ligji.

2. Kodi i sjelljes, i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përmban mekanizma që lejojnë organin e përmendur në nenin 45 që të kryejë, pa cenuar detyrat dhe kompetencat e Komisionerit mbikëqyrjen e përpunimit, monitorimin e detyrueshëm të përputhshmërisë me dispozitat e kodit, nga kontrolluesit ose përpunuesit të cilët janë zotuar publikisht t'i përmbahen këtij kodi.

3. Shoqatat dhe subjektet e tjera të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat kanë hartuar kodin e sjelljes ose dëshirojnë të ndryshojnë ose zgjerojnë kodin ekzistues, i paraqesin Komisionerit për miratim projekt-kodin, ndryshimin ose zgjerimin e tij, të cilin Komisioneri e miraton, nëse ai konstaton se kodi ofron masa të mjaftueshme dhe të përshtatshme mbrojtëse.

4. Pasi teksti i një kodi të paraqitur miratohet nga Komisioneri, zotëruesi i kodit propozon një nga organet monitoruese, të akredituara nga Komisioneri sipas nenit 45, për monitorimin e zbatimit të këtij kodi. Kodi mund të vihet në zbatim sapo Komisioneri të emërojë një organ specifik monitorimi për monitorimin e këtij kodi.

5. Dispozitat e paragrafit 4 nuk zbatohen për kodet e miratuara të zotëruesve të kodeve të sektorit publik.

6. Komisioneri mban një regjistër ku publikohen kodet e miratuara së bashku me organet e përcaktuara të monitorimit.

Neni 45

Organet monitoruese

1. Subjektet e sektorit privat mund të akreditohen nga Komisioneri për monitorimin e përputhshmërisë me kodin e sjelljes, kur subjekti

a) demonstroi pavarësinë dhe ekspertizën e tij në lidhje me çështjen objekt rregullimi nga kodi, në mënyrë të kënaqshme për Komisionerin;

b) përcakton procedura që i lejojnë atij të vlerësojë aftësinë e kontrolluesve dhe përpunuesve në fjalë për zbatimin e kodit, monitorimin e përputhshmërisë së tyre me dispozitat e tij dhe për të rishikuar në mënyrë periodike funksionimin e tij;

c) përcakton procedura dhe struktura për të trajtuar ankesat në lidhje me shkeljet e kodit ose mënyrën në të cilën është zbatuar ose po zbatohet kodi nga një kontrollues ose përpunues, dhe për t'i bërë ato procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun;

d) demonstroi në një nivel të kënaqshëm për Komisionerin që përgjegjësitë dhe detyrat e tij nuk shkaktojnë konflikt interesash.

2. Komisioneri përcakton me udhëzim kriteret për akreditim si organ monitorues.

3. Pa cenuar detyrat dhe kompetencat e Komisionerit, organi monitorues, në përputhje me masat e duhura mbrojtëse, vepron në rastet e shkeljes së kodit nga një kontrollues ose përpunues, i cili ka marrë përsipër t'i përmbahet kodit. Këto masa përfshijnë pezullimin ose përjashtimin e kontrolluesit ose përpunuesit në fjalë nga kodi. Organi monitorues informon Komisionerin për këto masa dhe për arsyet që çuan në ndërmarrjen e tyre. Komisioneri mund t'i anulojë këto masa në çdo moment.

4. Komisioneri revokon akreditimin e një organi monitorues nëse nuk plotësohen, ose nuk plotësohen në vijimësi kushtet për akreditim ose nëse masat e marra nga subjekti në fjalë shkelin këtë ligj.

Neni 46 **Certifikimi**

1. Komisioneri përcakton, me udhëzim, kriteret e përgjithshme të kërkuara për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave. Këto instrumente i demonstrojnë publikut se veprimi përkatës i përpunimit ose të gjitha veprimet e përpunimit të një kontrolluesi ose përpunuesi e kanë kaluar me sukses procesin e certifikimit. Vulat dhe shenjat e mbrojtjes së të dhënave shërbejnë që kontrolluesit dhe përpunuesit të jenë në gjendje të demonstrojnë më mirë përputhshmërinë me këtë ligj.

2. Kërkesa për certifikim bëhet nga vetë subjekti dhe certifikimi jepet përmes një procesi transparent. Kontrolluesi ose përpunuesi, i cili paraqet përpunimin e tij për certifikim, i ofron organit të certifikimit, të përmendur në nenin 47, të gjithë informacionin dhe aksesin në veprimtaritë e përpunimit të cilat janë të nevojshme për kryerjen e procedurës së certifikimit.

3. Procesi i përpunimit që do të certifikohet, kontrollohet nga organizmi certifikues nëse përmbush të gjitha kërkesat e mekanizmit të certifikimit të miratuar nga Komisioneri në kuadër të akreditimit të organizmit certifikues në përputhje me nenin 47. Marrja e certifikimit në përputhje me këtë nen konfirmon që procesi i përpunimit i certifikuar kryhet në përputhje me një mekanizëm certifikimi të miratuar nga Komisioneri.

4. Vulat dhe shenjat e mbrojtjes së të dhënave mund të përdoren vetëm nga ata kontrollues ose përpunues që kanë marrë certifikimin e duhur për proceset e përpunimit.

5. Marrja e certifikimit nuk përjashton përgjegjësinë e kontrolluesit ose përpunuesit për përputhshmërinë me këtë ligj dhe nuk cenon detyrat dhe kompetencat mbikëqyrëse të Komisionerit në përputhje me këtë Ligj.

6. Certifikimi i lëshohet kontrolluesit ose përpunuesit për një periudhë maksimale prej tre vjetësh dhe mund të rinovohet, sipas të njëjtave kushte, për sa kohë që kërkesat përkatëse vijnë në plotësohen. Certifikimi tërhiqet nga organizmi përgjegjës i certifikimit, kur kërkesat e certifikimit nuk janë plotësuar ose nuk plotësohen më.

7. Organizmat e certifikimit i japin Komisionerit arsyet për dhënien ose tërheqjen e një certifikimi.

8. Komisioneri, në udhëzimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, në raste të veçanta, mund të përcaktojë sektorë apo kategori kontrolluesish për të cilët zbatimi i mekanizmit të certifikimit bëhet i detyrueshëm.

Neni 47

Organizmat e certifikimit

1. Certifikimi mund të jepet vetëm nga organizmat e certifikimit të cilat janë akredituar nga Komisioneri. Akreditimi jepet nëse organizmi aplikues plotëson kërkesat e renditura në paragrafin 2, të cilat përcaktohen me udhëzim të Komisionerit. Akreditimi lëshohet për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh dhe mund të rinovohet me të njëjtat kushte si akreditimi fillestar.

2. Organizmat e përmendur në paragrafin 1 akreditohen vetëm nëse plotësojnë, në nivel të kënaqshëm, të gjitha kriteret e mëposhtme të akreditimit, përfshirë edhe ato të përcaktuara në udhëzimin e Komisionerit në përputhje me paragrafin 1. Një organizëm certifikues duhet:

- a) të ketë nivelin e duhur të njohurive në lidhje me trajtimin e certifikimit, vulave ose shenjave, si dhe në lidhje me zbatimin e mbrojtjes së të dhënave për lëndën objekt certifikimi;
- b) të demonstrojë pavarësi dhe të angazhohet në ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të tij në një mënyrë që nuk shkakton konflikt interesi;
- c) të paraqesë një mekanizëm certifikimi, që konsiston në dokumentimin e kriterëve dhe procedurave që do të zbatohen për vlerësimin e proceseve të përpunimit dhe lëshimin, rishikimin periodik dhe tërheqjen e certifikimit të mbrojtjes së të dhënave, vulave dhe shenjave;
- d) të angazhohet për të respektuar, sot dhe në të ardhmen, kriteret e certifikimit, të përcaktuara me udhëzim të Komisionerit në përputhje me paragrafin 1 të nenit 46 dhe rrjedhimisht, mekanizmin e certifikimit, të miratuar nga Komisioneri në kuadër të akreditimit të organizmit certifikues;
- e) të paraqesë dokumentacion lidhur me procedurat dhe strukturat për trajtimin e ankesave në lidhje me shkeljet e këtij ligji, me mënyrën se si është dhënë, ose se si është zbatuar, ose po zbatohet certifikimi nga kontrolluesi ose përpunuesi, dhe për t'i bërë ato procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun.

3. Organizmat e certifikimit janë përgjegjës për vlerësimin e duhur, që çon në dhënien e certifikimit, ose, tërheqjen e këtij certifikimi, pa cenuar përgjegjësinë e kontrolluesit ose përpunuesit në lidhje me përputhshmërinë me këtë ligj.

4. Komisioneri revokon akreditimin e një organizmi certifikues, kur kushtet e akreditimit nuk janë plotësuar ose nuk plotësohen në vijimësi ose nëse masat e marra nga organizmi certifikues shkelin këtë ligj.

PJESA III

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE NGA AUTORITETET KOMPETENTE PËR SIGURINË PUBLIKE OSE KOMBËTARE DHE

KAPITULLI I
Dispozita të përgjithshme

Neni 48

Fusha e zbatimit

Dispozitat e pjesës III zbatohen lidhur me përpunimin e të dhënave personale të përmendura në paragrafin 1 të nenit 2, të këtij ligji nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, duke përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Neni 49

Përkufizime

1. Përkufizimet e përcaktuara në paragrafin 1 deri 3, 5 deri 10, 12 deri 16, 19, 20, 23 dhe 26 të nenit 5, zbatohen me kushtin që termi “kontrollues” t’i referohet një autoriteti kompetent sipas fushës së zbatimit të kësaj Pjese.

2. “Autoritet kompetent” është çdo autoritet publik kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare, ose çdo institucion tjetër, që gëzon me ligj të drejtën për ushtrimin e autoritetit zyrtar për një ose disa prej këtyre qëllimeve.

KAPITULLI II

Përpunimi i të dhënave personale

Seksioni 1

Parimet dhe kushtet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale

Neni 50

Parimet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj Pjese kryhet nga autoritetet kompetente në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 6, si dhe në përputhje me nenin 52 lidhur me përpunimin e mëtejshëm për qëllime të tjera.

Neni 51

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale

Përveç nëse kërkohet për mbrojtjen e interesave jetike të një personi, përpunimi i të dhënave personale sipas Pjesës III është i ligjshëm vetëm nëse dhe deri në masën që parashikohet me ligj dhe është i domosdoshëm dhe proporcional për përmbushjen e një detyre nga autoriteti kompetent për qëllimet e përmendura në nenin 48.

Neni 52

Përpunimi për qëllime të tjera

1. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale nga i njëjti ose një autoritet tjetër kompetent për ndonjë nga qëllimet e përcaktuara në nenin 48, lejohet, kur kontrolluesi është i autorizuar nga ligji për të realizuar qëllimin tjetër, dhe për aq sa është e nevojshme dhe në proporcion me qëllimin e ri.
2. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në nenin 48, mund të kryhet vetëm kur kjo autorizohet shprehimisht nga ligji. Përpunimi për këtë qëllim të ri i nënshtrohet dispozitave të Pjesës II të këtij Ligji.
3. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime arkivimi për interes publik, për qëllim kërkimor historik ose shkencor ose qëllime statistikore, lejohet duke iu nënshtuar masave mbrojtëse të përshtatshme për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave në përputhje me paragrafin 3 të nenin 16.

Neni 53

Dallimi dhe cilësia e të dhënave

1. Për aq sa është e mundur, bëhet një dallim i qartë midis të dhënave personale të kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave, si më poshtë:
 - a) personat në lidhje me të cilët ka arsye të forta për të besuar se ata kanë kryer ose do të kryejnë një veprë penale;
 - b) personat e dënuar për një veprë penale;
 - c) viktimat të një veprë penale ose persona për të cilët disa fakte japin arsye për të besuar se ata janë viktimat të një veprë penale; dhe
 - d) persona të tjerë të lidhur me një veprë penale, siç janë personat që mund të thirren për të dëshmuar, personat që mund të japin informacione për veprat penale, ose kontaktet ose bashkëpunëtorët e njërit prej personave të përmendur në pikat (a) dhe (b) të këtij paragrafi.
2. Të dhënat personale të bazuara në fakte duhet të dallohen, për aq sa është e mundur, nga të dhënat personale të bazuara në vlerësime personale. Të dhënat personale të bazuara në vlerësime personale shënohen në përputhje me rrethanat, dhe arsyet mund të shtohen për të lehtësuar të kuptuarin e një vlerësimi.
3. Të dhënat personale të pasakta ose të paplota, ose të dhënat që nuk janë më të përditësuara ose duhet të ishin fshirë, nuk transferohen dhe as nuk vihen në dispozicion, veçanërisht për efekt të ruajtjes automatike nga sistemet e arkivimit. Për këtë qëllim, autoriteti kompetent, verifikon, për aq sa është e mundur, cilësinë e të dhënave para transmetimit. Të dhënat personale të mbajtura gati për ruajtje automatike mbahen të plota dhe të përditësuara në çdo kohë.
4. Për aq sa është e mundur, së bashku me çdo transmetim të të dhënave personale, jepen informacione shtesë që i japin mundësi marrësit që të vlerësojë përditësimin, korrektesinë, plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave personale të transmetuara.

5. Nëse rezulton se janë transmetuar të dhëna personale të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e paragrafit 3, autoriteti kompetent për transmetimin ose autoriteti kompetent që mban sistemin e arkivimit e njofton pa vonesa marrësin. Marrësi fshin menjëherë të dhënat që janë transmetuar në mënyrë të paligjshme, korrigjon të dhënat e pasakta, plotëson të dhënat jo të plota ose kufizon menjëherë përpunimin.

6. Nëse autoriteti kompetent pritës ka arsye të besojë se të dhënat personale të transmetuara janë të pasakta ose të papërditësuara ose duhet të fshihen, ose që përpunimi i tyre do të duhej të kufizohej, ai njofton menjëherë autoritetin kompetent transmetues. Ky i fundit merr menjëherë masat e nevojshme.

Neni 54

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave sensitive

1. Përveç kur është e nevojshme për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër, përpunimi i të dhënave sensitive nga autoritetet kompetente lejohet vetëm kur ky përpunim:

- a) autorizohet në mënyrë specifike me ligj; ose
- b) ka të bëjë me të dhëna të cilat janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave dhe i shërben një qëllimi për të cilin kontrolluesi është kompetent sipas ligjit.

Kufizimet e posaçme sipas paragrafit 2 të nenit 55 duhen të merren parasysh në këtë rast.

2. Gjithsesi përpunimi duhet të kufizohet në ato të dhëna që janë të domosdoshme dhe duhet të ekzistojnë masa të përshtatshme mbrojtëse për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave.

Neni 55

Vendimmarrja individuale automatike

1. Vendimet e bazuara vetëm tek përpunimi automatik, përfshirë profilizimin, të cilat kanë pasoja ligjore negative për subjektin e të dhënave ose mund të ndikojnë ndjeshëm tek subjekti i të dhënave, janë të ndaluara përveç nëse parashikohen shprehimisht me ligj. Kur një vendim bazohet vetëm tek përpunimi automatik, subjekti i të dhënave gëzon të drejtën t'i sigurohet ndërhyrje manuale nga ana e kontrolluesit.

2. Vendimet e përmendura në paragrafin 1 nuk mund të bazohen në të dhëna sensitive nëse nuk ekzistojnë masa të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat dhe liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave. Vendimet në përputhje me paragrafin 1, që rezultojnë diskriminuese për personat për shkak të të dhënave sensitive, janë të ndaluara.

Seksioni 2

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

Neni 56

Parimet e përgjithshme për transferimin ndërkombëtar të të dhënave ndërmjet autoriteteve kompetente

1. Pa cenuar dispozitat e tjera të Pjesës III që rregullojnë përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, transferimi i të dhënave personale që po përpunohen ose synojnë të përpunohen pas transferimit, nga një autoritet kompetent, në një vend tjetër ose organizatë ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm, nëse:

a) marrësi është një autoritet tjetër kompetent;

b) transferimi është kryer për një ose disa nga qëllimet e përcaktuara në nenin 48; dhe

c) plotësohen kushtet e parashikuara në paragrafët 2 deri 4 të këtij neni dhe në nenet 57-59.

2. Të gjitha dispozitat e Seksionit 2 zbatohen në mënyrë që të garantohet që niveli i mbrojtjes së personave siç parashikohet në Pjesën III, të mos cenohet.

3. Në të gjitha rastet e transferimeve sipas paragrafit 1, duhet të sigurohet që çdo transferim i mëtejshëm në një vend ose organizatë tjetër ndërkombëtare lejohet vetëm me autorizimin paraprak nga autoriteti kompetent që ka kryer transferimin fillestar. Autorizimet për transferime të mëtejshme marrin parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë seriozitetin e veprës penale, qëllimin për të cilin të dhënat personale u transferuan fillimisht dhe nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në vendin ose organizatën tjetër ndërkombëtare ku transferohen më tej të dhënat personale.

4. Transferimet sipas neneve 58 ose 59 dokumentohen në mënyrë të posaçme dhe dokumentacioni vihet në dispozicion të Komisionerit me kërkesë, duke përfshirë datën dhe kohën e transferimit, informacionin në lidhje me autoritetin kompetent pritës, arsyetimin e transferimit dhe të dhënat personale të transferuara.

Neni 57

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave ndërmjet autoriteteve kompetente drejt vendeve me nivel të mjaftueshëm mbrojtje të të dhënave

Transferimet ndërkombëtare të të dhënave në përputhje me gërmat (a) dhe (b) të paragrafit 1 të nenit 56, mund të kryhen, nëse shteti, një territor ose një apo më shumë sektorë specifikë, ose organizata ndërkombëtare ku transferohen të dhënat personale, garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtje të të dhënave në përputhje me paragrafët 2-4 të nenit 12. Këto transferime nuk kërkojnë autorizim specifik.

Neni 58

Transferimet ndërkombëtare të të dhënave tek autoritetet kompetente drejt vendeve që nuk kanë nivel të mjaftueshëm mbrojtje të të dhënave

1. Transferimet ndërkombëtare të të dhënave tek një autoritet kompetent në një shtet ose një organizatë ndërkombëtare që nuk garanton nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, mund të bëhen nëse:

- a) sigurohen masa të përshtatshme mbrojtëse në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet një instrumenti ligjor të detyrueshëm; ose
 - b) kontrolluesi i transferimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat që lidhen me transferimin e të dhënave personale dhe arrin në përfundimin se ekzistojnë masa të përshtatshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi informon Komisionerin për kategoritë e transferimeve sipas gjurmës b) të paragrafit 1. Komisionerit i jepen të dhëna shtesë me kërkesë të tij.

Neni 59

Përjashtimet për situata specifike

1. Me përjashtim të paragrafit 1 të nenit 58, transferimet ndërkombëtare të të dhënave mund të kryhen në mungesë të masave të përshtatshme mbrojtëse, me kusht që transferimi të jetë i nevojshëm:
 - a) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave ose një personi tjetër;
 - b) për të mbrojtur interesat legjitime të subjektit të të dhënave, kur e parashikon ligji;
 - c) për të parandaluar një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe serioz ndaj sigurisë publike të Republikës së Shqipërisë ose të një shteti tjetër;
 - d) në raste individuale për qëllimet e përcaktuara në nenin 48, kur transferimi është i domosdoshëm dhe masat e përshtatshme mbrojtëse nuk mund të zbatohen në kohën e duhur; ose
 - e) në një rast individual për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore në lidhje me qëllimet e përcaktuara në nenin 48.
2. Të dhënat personale nuk transferohen nëse autoriteti kompetent për transferimin vendos se të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave në fjalë kanë përparësi mbi interesin publik në lidhje me transferimin e përcaktuar në gjërat d) dhe e) të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 60

Transferimet ndërkombëtare të të dhënave tek marrës që nuk janë autoritete kompetente

1. Pa cenuar asnjë marrëveshje ndërkombëtare në fuqi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale dhe bashkëpunimit policor, autoritetet kompetente, të cilat janë autoritete publike, në raste individuale dhe specifike mund të transferojnë të dhëna personale drejtpërdrejtë tek marrës të huaj, që nuk janë autoritete kompetente, nëse veprohet në përputhje me të gjithë nenet e Pjesës III dhe, në veçanti, me nenet 51, 52 dhe 54, dhe nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) transferimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre, që i caktohet me ligj autoritetit kompetent për transferimin, brenda qëllimeve të përcaktuara në nenin 48;

- b) autoriteti kompetent transferues del në përfundimin se asnjë e drejtë dhe liri themelore e subjektit të të dhënave nuk ka përparësi mbi interesin publik që kërkon transferimin në rastin në fjalë;
- c) autoriteti kompetent transferues konsideron se transferimi paraprak tek një autoritet që është kompetent për qëllimet e përmendura në nenin 48 në shtetin tjetër, është joefektiv ose i papërshtatshëm, veçanërisht për shkak se transferimi nuk mund të realizohet në kohën e duhur;
- d) autoriteti që është kompetent në shtetin tjetër për qëllimet e përmendura në nenin 48, vihet në dijeni pa vonesë, përveç nëse diçka e tillë është joefektive ose e papërshtatshme;
- e) autoriteti kompetent transferues informon marrësin për qëllimin ose qëllimet e specifikuar për të cilët të dhënat personale do të përpunohen ekskluzivisht nga ky i fundit, me kusht që ky përpunim të jetë i domosdoshëm, dhe veçanërisht, që çdo transferim i mëtejshëm të marrë autorizim paraprak nga autoriteti kompetent transferues.

2. Autoriteti kompetent transferues informon Komisionerin për transferimet sipas paragrafit 1. Këto transferime dokumentohen në mënyrë të posaçme dhe dokumentacioni vihet në dispozicion të Komisionerit me kërkesë, duke përfshirë datën dhe kohën e transferimit, informacionin në lidhje me autoritetin kompetent pritës, arsyetimin e transferimit dhe të dhënat personale të transferuara.

KAPITULLI III

Të drejtat e subjektit të të dhënave

Neni 61

Komunikimi dhe mënyrat e ushtrimit të të drejtave të subjektit të të dhënave

1. Komunikimi me subjektin e të dhënave dhe ushtrimi i të drejtave të subjektit të të dhënave sipas neneve 62-64 kryhet në përputhje me nenin 19 të këtij Ligji.
2. Për shkak të mundësisë së zbatimit të kufizimeve në përgjigjet ndaj kërkesave sipas neneve 63 dhe 64, subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë nga Komisioneri verifikimin e ligjshmërisë së të gjitha këtyre përgjigjeve. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave për këtë të drejtë.
3. Kur ushtrohet e drejta e përmendur në paragrafin 2, Komisioneri informon subjektin e të dhënave të paktën për faktin që janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme ose rishikimi nga Komisioneri. Gjithashtu, Komisioneri informon subjektin e të dhënave për të drejtën e tij për t'u ankuar në gjykatën administrative kompetente.

Neni 62

E drejta për informim

1. Kur subjekti i të dhënave nuk e ka informacionin, kontrolluesi vë në dispozicion të subjektit të të dhënave të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) identitetin dhe të dhënat e kontaktit të kontrolluesit dhe, kur është e zbatueshme, të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave,
- b) qëllimet e përpunimit për të cilat merren të dhënat personale,
- c) bazën ligjore për përpunimin, dhe
- d) ekzistencën e të drejtave për akses, korrigjim, fshirje dhe bllokim të të dhënave, si dhe të drejtën për të paraqitur ankesë tek Komisioneri, duke përfshirë të dhënat e kontaktit të Komisionerit.

2. Informacion shtesë jepet për aq sa është e nevojshme për të bërë një përpunim të drejtë, në veçanti, kur të dhënat u zbulohen palëve të treta dhe kur të dhënat personale mblidhen pa dijeninë e subjektit të të dhënave. Në lidhje me informacionin për burimin e mbledhjes së këtyre të dhënave, duhet t'i kushtohet vëmendje të drejtave themelore dhe interesave legjitime të personave të përfshirë në cilësinë e burimit të të dhënave.

3. Në raste të veçanta, dhënia e informacionit për subjektin e të dhënave në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 mund të vonohet, kufizohet ose refuzohet në atë masë dhe për aq kohë sa është e nevojshme dhe proporcionale, duke marrë parasysh të drejtat themelore dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave:

- a) për të shmangur pengesat në parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, në veçanti duke pënguar kërkimet, hetimet, procedurat nga autoritetet ose procesin gjyqësor;
- b) për të mbrojtur sigurinë publike;
- c) për të mbrojtur sigurinë kombëtare; ose
- d) për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 63

E drejta për akses

1. Çdo subjekt të dhënash gëzon të drejtën të marrë nga kontrolluesi konfirmimin nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar ose jo, dhe, sipas rastit, të ketë akses tek të dhënat personale sipas nenit 21. Lidhur me informacionin për burimin, në rastet kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave, duhen marrë në konsideratë të drejtat themelore dhe interesat legjitim të personave të përfshirë në cilësinë e burimit të të dhënave.

2. Kufizimet e të drejtës për akses lejohen vetëm në rrethanat e përmendura në paragrafin 3 të nenit 62.

3. Në mënyrë që kufizimet të jenë efektive, përgjigjet ndaj një kërkesë për akses mund të standardizohen në mënyrë që të mos zbulohet nëse janë zbatuar ose jo kufizimet në përputhje me paragrafin 2. Në çdo përgjigje ndaj një kërkesë për akses, subjekti i të dhënave duhet të informohet për mundësinë e paraqitjes së ankesës tek Komisioneri për rishikimin e përgjigjes.

4. Kontrolluesi dokumenton arsyet e refuzimit të aksesit sipas paragrafit 2 dhe e vë këtë informacion në dispozicion të Komisionerit.

E drejta për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale dhe për kufizimin e përpunimit

1. Në çdo rast që një kontrollues merr dijeni për pasaktësinë ose për faktin se të dhënat personale të përpunuara nga ai janë të paplota, ai korrigjon ose plotëson menjëherë këto të dhëna. I njëjti rregull zbatohet kur një subjekt i të dhënave kërkon korrigjimin ose plotësimin e të dhënave të tij dhe kontrolluesi bie dakord që të dhënat duhet të korrigjohen ose plotësohen. Kur është e nevojshme, të dhënat personale mund të korrigjohen ose plotësohen me anë të një deklaratë shtesë nëse ndryshimet e mëtejshme nuk janë në përputhje me dokumentacionin që është objekt përpunimi.

2. Në çdo rast që një kontrollues merr dijeni që të dhënat personale po përpunohen në mënyrë të paligjshme nga ai, veçanërisht për shkak të shkeljes së neneve 6 ose 51-54, ai i fshin menjëherë këto të dhëna. I njëjti rregull zbatohet kur një subjekt i të dhënave kërkon fshirjen e të dhënave të tij ose të saj, dhe kontrolluesi bie dakord që të dhënat janë përpunuar në mënyrë të paligjshme.

3. Në vend të fshirjes, kontrolluesi kufizon përpunimin kur:

- a) saktësia e të dhënave personale kundërshtohet nga subjekti i të dhënave dhe saktësia ose pasaktësia e tyre nuk mund të konstatohet; ose
- b) të dhënat personale duhet të mbahen si prova për kryerjen e një detyre që i është caktuar kontrolluesit me ligj.

Në rastin e një kufizimi sipas pikës (a), kontrolluesi informon subjektin e të dhënave para se të hiqet kufizimi.

4. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave me shkrim për refuzimin e korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit, si dhe për arsyet e refuzimit. Informacioni në lidhje me arsyet e refuzimit të korrigjimit, fshirjes ose kufizimit, mund të kufizohet, tërësisht ose pjesërisht, në ato raste dhe në masën që dhënia i tij do të dëmtonte qëllimin sipas paragrafit 3 të nenit 62, të këtij Ligji. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave për mundësinë e paraqitjes së ankesës tek Komisioneri për rishikimin e përgjigjes së kontrolluesit.

5. Kontrolluesi i komunikon korrigjimin e të dhënave personale të pasakta autoritetit kompetent nga i cili janë marrë të dhënat personale të pasakta.

6. Kur të dhënat personale janë korrigjuar ose fshirë ose kur është kufizuar përpunimi sipas paragrafëve 1-3, kontrolluesi njofton të gjithë marrësit e të dhënave personale në fjalë. Marrësit korrigjojnë ose fshijnë të dhënat personale ose kufizojnë menjëherë përpunimin e të dhënave personale për të cilat janë përgjegjës.

Detyrimet e kontrolluesit dhe të përpunuesit

Seksioni 1 **Përgjegjësia**

Neni 65

Detyrimet e kontrolluesit

Kontrolluesi vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 29, dhe në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 41 në lidhje me përputhshmërinë e përpunimit me dispozitat e Pjesës III.

Neni 66

Kontrollues të përbashkët

Kur dy ose më shumë kontrollues përcaktojnë bashkërisht qëllimet dhe mjetet e përpunimit, zbatohen paragrafët 1 dhe 3 të nenit 30, me kusht që referencat për të drejtat e subjektit të të dhënave dhe detyrat përkatëse të kontrolluesit të jenë në përputhje me të drejtat dhe detyrat përkatëse sipas kësaj Pjesë të Ligjit.

Neni 67

Marrëdhënia midis kontrolluesit dhe përpunuesit

1. Kur përpunimi kryhet në emër të një kontrolluesi, zbatohen paragrafët 1-4 dhe 8 të nenit 31, me kusht që referencat tek dispozitat e Pjesës I të këtij Ligji t'i referohen, kur është e zbatueshme, dispozitave përkatëse të Pjesës III të këtij Ligji.
2. Përpunuesi dhe çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, që ka akses tek të dhënat personale, i përpunon ato të dhëna vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit, përveç nëse kërkohet të veprojnë ndryshe me ligj.

Neni 68

Bashkëpunimi me Komisionerin

Kontrolluesi dhe përpunuesi bashkëpunojnë, mbi bazë kërkesë, me Komisionerin për kryerjen e detyrave të tyre. Në veçanti, kontrolluesi dhe përpunuesi i japin Komisionerit çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e këtyre detyrave. Në rast se kanë marrë një rekomandim ose urdhër nga Komisioneri, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të informojnë Komisionerin për shkallën e përmbushjes, menjëherë pas afatit të caktuar në të.

Seksioni 2 **Siguria e përpunimit**

Neni 69

Siguria e përpunimit

1. Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, kostot e zbatimit dhe natyrën, fushën e zbatimit, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe mundësinë e shfaqjes dhe përshkallëzimit të rrezikut për të drejtat dhe liritë e personave, kontrolluesi dhe përpunuesi zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të përshtatshëm sigurie ndaj rrezikut, veçanërisht në lidhje me përpunimin e të dhënave sensitive të përmendura në nenin 54.

2. Në lidhje me përpunimin automatik dhe, kur është e zbatueshme, në lidhje me përpunimin joautomatik në sistemet e arkivimit, kontrolluesit dhe përpunuesit, pas vlerësimit të rreziqeve, zbatojnë masa që kanë për qëllim:

- a) të mos lejojnë persona të paautorizuar të kenë akses në pajisjet e përpunimit të përdorura për përpunim (“kontrolli i aksesit në pajisje”);
- b) të parandalojnë leximin, kopjimin, ndryshimin ose fshirjen e paautorizuar të mjeteve me të dhëna (“kontrolli i mjeteve me të dhëna”);
- c) të ndalojnë hedhjen e paautorizuar të të dhënave personale dhe inspektimin, ndryshimin ose fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura (“kontrolli i ruajtjes”);
- d) të parandalojnë përdorimin e sistemeve automatike të përpunimit nga persona të paautorizuar duke përdorur pajisjet e komunikimit të të dhënave (“kontrolli i përdoruesit”);
- e) të garantojnë se personat e autorizuar për të përdorur një sistem automatik përpunimi, kanë akses vetëm tek të dhënat personale që përfshihen në autorizimin e tyre për akses (“kontrolli i aksesit së të dhënave”);
- f) të garantojnë se është e mundur të verifikohen dhe përcaktohen organet ku të dhënat personale janë transmetuar ose mund të transmetohen ose të vihen në dispozicion duke përdorur pajisjet e komunikimit të të dhënave (“kontrolli i komunikimit”);
- g) të garantojnë se është në vijim e mundur të verifikohet dhe përcaktohet, cilat të dhëna personale janë hedhur në sistemet e përpunimit automatik, kur dhe nga kush janë hedhur të dhënat personale (“kontrolli i hedhjes së të dhënave”);
- h) të parandalojnë leximin, kopjimin, ndryshimin ose fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale gjatë transferimit të të dhënave personale ose gjatë transportimit të mjeteve të të dhënave (“kontrolli i transportit”);
- i) të garantojnë se sistemet e instaluar, në rast ndërprerjeje, mund të rikthehen në gjendje pune (“rekuperimi”);
- j) të garantojnë se funksionet e sistemit kryhen, se shfaqja e defekteve në funksione raportohet (“besueshmëria”) dhe se të dhënat personale të ruajtura nuk mund të korruptohen nga mosfunksionimi i sistemit (“integriteti”).

3. Kontrolluesi dokumenton masat teknike dhe organizative të përshtatura dhe të zbatuara për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Komisioneri, me udhëzim, specifikon më tej rregullat e hollësishme për sigurinë e të dhënave dhe rregullon procedurat për administrimin e regjistrimit të të dhënave, hedhjen e të dhënave, përpunimin dhe zbulimin e tyre.

Cenimi i të dhënave personale

1. Në përputhje me nenin 34, kontrolluesi njofton Komisionerin për cenimin e të dhënave.
2. Kur cenimi i të dhënave mund të përbëjë një rrezik të madh për të drejtat dhe liritë e personave, kontrolluesi ia komunikon menjëherë cenimin e të dhënave subjektit të të dhënave. Ky komunikim përshkruan me gjuhë të qartë dhe të thjeshtë natyrën e cenimit të të dhënave dhe përmban të paktën informacionin dhe masat e përmendura në gërmat (b), (c) dhe (d) të paragrafit 3 të nenit 34.
3. Komunikimi me subjektin e të dhënave i përmendur në paragrafin 2 nuk është i nevojshëm nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:
 - a) kontrolluesi ka zbatuar masat e duhura mbrojtëse nga pikëpamja teknike dhe organizative dhe i ka zbatuar ato tek të dhënat personale të prekura nga cenimi i të dhënave, në veçanti ato që i bëjnë të dhënat personale të pakuptueshme për çdo person që nuk është i autorizuar t'i aksesojë, siç është enkriptimi;
 - b) kontrolluesi ka marrë masa të mëtijshme që garantojnë se rreziku i lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave të përmendura në paragrafin 2 nuk ka më mundësi të materializohet; ose
 - c) do të përbënte një përpjekje joproporcionale. Në këtë rast, në vend të komunikimit individual, do të ketë një komunikim publik ose një masë të ngjashme me anë të së cilës subjektet e të dhënave informohen në një mënyrë po aq efektive.
4. Nëse kontrolluesi nuk ia ka komunikuar cenimin e të dhënave subjektit të të dhënave, Komisioneri, pasi merr parasysh probabilitetin që cenimi i të dhënave të përbëjë një rrezik të madh, mund t'i kërkojë kontrolluesit që ta kryejë këtë komunikim, ose mund të vendosë që është përmbushur një nga kushtet e përmendura në paragrafin 3.
5. Komunikimi me subjektin e të dhënave i përmendur në paragrafin 2 mund të vonohet, kufizohet ose refuzohet, në varësi të kushteve dhe arsyeve të përmendura në paragrafin 3 të nenit 62.

Seksioni 3

Dokumentimi, regjistrimi dhe vlerësimi i ndikimit

Neni 71

Detyrimi për të dokumentuar

Çdo kontrollues dhe përpunues mban dokumentacionin e veprimtarive të përpunimit, duke zbatuar nenin 35 në përputhje me rrethanat, me kusht që referencat në dispozitat e Pjesës II të këtij Ligji të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të Pjesës III të tij. Dokumentacioni i mbajtur nga kontrolluesi përmban gjithashtu informacione për përdorimin e profilizimit, kur është e zbatueshme.

Neni 72

Regjistrimi

1. Veprimet e përpunimit, në veçanti konsultimet dhe përhapjet, përfshirë transmetimet, ndryshimet, korrigjimet dhe fshirjet, regjistrohen në një mënyrë të përshtatshme që garanton se ligjshmëria e përpunimit mund të monitorohet dhe verifikohet. Në sistemet e përpunimit automatik, regjistrimi përfshin çdo veprim mbledhjeje ose kombinimi. Të dhënat e regjistrimit, në veçanti në lidhje me konsultimin dhe përhapjen, bëjnë të mundur përcaktimin e arsyes, datës dhe kohës së këtyre veprimeve dhe, për aq sa është e mundur, identifikimin e personit që ka konsultuar ose përhapur të dhënat personale si dhe identitetin e çdo marrësi të këtyre të dhënave personale.

2. Regjistrimet përdoren vetëm për të verifikuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave, përfshirë vetëmonitorimin, veçanërisht në lidhje me shkeljet e etikës për profesionet e rregulluara, për të siguruar integritetin dhe sigurinë e përpunimit të të dhënave personale, si dhe për procedimin penal ose për të garantuar sigurinë kombëtare. Regjistrimet mbahen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur.

3. Kontrolluesi dhe përpunuesi vendosin në dispozicion të Komisionerit, regjistrimet sipas kërkesës së këtij të fundit

Neni 73

Vlerësimi i Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave

Përpara fillimit të një aktiviteti të ri përpunimi, kontrolluesi bën një vlerësim të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave në përputhje me paragrafët 1-5 dhe 9-11 të nenit 36 të këtij Ligji.

Neni 74

Konsultimi paraprak me Komisionerin

1. Në përputhje me nenin 37, kontrolluesi konsultohet me Komisionerin, kur vlerësimi i ndikimit të kryer në përputhje me nenin 73 tregon, se përpunimi do të përbënte rrezik të madh, për faktin se masat për të zbutur ndjeshëm rrezikun nuk janë lehtësisht të zbatueshme ose sepse do të përdoren teknologji, mekanizma ose procedura të reja. Kontrolluesi duhet t'i sigurojë Komisionerit të gjitha informacionet e përmendura në paragrafin 3 të nenit 37. Kontrolluesit mund t'ia besojnë përpunuesit të tyre konsultimin me Komisionerin.

2. Komisioneri vepron sipas paragrafit 2 të Nenit 37.

3. Kur veprimet e përpunimit të të dhënave personale për qëllimet e përcaktuara në nenin 48 rregullohen me ligj ose akt nënligjor, merret mendimi i Komisionerit për rreziqet që mund të paraqesë përpunimi.

4. Komisioneri mund të publikojë me vendim veprimet e përpunimit për qëllimet e nenit 48, për të cilat nevojitet konsultim paraprak.

Seksioni 4

Instrumente të veçanta që ndihmojnë përputhshmërinë

Neni 75

Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave

Autoritetet kompetente, me përjashtim të gjykatave kur veprojnë në kuadër të veprimtarisë së tyre gjyqësore, caktojnë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij Ligji.

Neni 76

Mekanizmat konfidencialë të raportimit

Autoritetet kompetente krijojnë mekanizma efektivë për të promovuar raportimin konfidencial të shkeljeve të dispozitave të Pjesës III.

PJESA IV

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Seksioni I

Statusi i pavarur

Neni 77

Komisioneri

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti i pavarur përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji, që ka për qëllim të mbrojë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e tyre, si një e drejtë dhe liri themelore e njeriut.
2. Komisioneri është person juridik publik.
3. Paga e Komisioneri vendoset nga Kuvendi.

Neni 78

Pavarësia dhe papajtueshmëria e funksioneve

1. Komisioneri vepron në pavarësi të plotë gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe ushtrimit të kompetencave të tij në përputhje me këtë Ligj.
2. Komisioneri nuk ndikohet në ushtrimin e detyrës së tij, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe nuk kërkon apo merr udhëzime nga askush. Komisioneri nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie politike ose të kryejë ndonjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore.
3. Komisioneri vepron në përputhje me detyrat e tij dhe gjatë mandatit nuk angazhohet në veprimtari të papajtueshme, fitimprurëse ose jo, dhe, në veçanti, nuk bëhet pjesë e organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse, apo atyre me karakter ekonomik ose tregtar.

4. Komisioneri ka një buxhet të veçantë të cilin e administron në mënyrë të pavarur. Ai propozon buxhetin në përputhje me legjislacionin përkatës. Buxheti dhe numri i punonjësve të Zyrës së Komisionerit përcaktohet nga Kuvendi. Buxheti i Komisionerit mund të financohet edhe nga donatorë, të cilët nuk paraqesin konflikt interesi. Administrimi i këtyre donacioneve bëhet sipas marrëveshjeve me donatorët dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

5. Komisioneri i nënshtrohet kontrollit financiar, për sa kohë kjo nuk ndikon tek pavarësia e tij.

Neni 79

Zyra e Komisionerit burimet njerëzore dhe financiare

1. Zyra e Komisionerit pajiset me burimet njerëzore, teknike dhe financiare, mjediset dhe infrastrukturën e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të saj.

2. Komisioneri zgjedh personelin e tij, i cili i nënshtrohet drejtimit ekskluziv të tij. Personeli me profil ligjor dhe teknik i Zyrës së Komisionerit gëzon statusin e nëpunësit civil. Nëpunësi civil më i lartë në stafin e Zyrës së Komisionerit është Sekretari i Përgjithshëm.

3. Kuvendi vendos për strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave të personelit të Zyrës së Komisionerit.

4. Informacioni në të cilin Komisioneri dhe stafi i tij ka pasur akses gjatë ushtrimit të detyrave të tyre përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes në përputhje me këtë Ligj, përveç nëse ky informacion lidhet me një vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast Komisioneri vë në dijeni autoritetin kompetent të ndjekjes penale.

Seksioni 2

Zgjedhja dhe mbarimi i mandatit

Neni 80

Zgjedhja dhe mandati

1. Komisioneri duhet të ketë kualifikimet, përvojën dhe aftësitë e kërkuara sipas nenit 81. Komisioneri zgjidhet për një mandat 7-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, me propozim të Këshillit të Ministrave, me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

2. Propozimi i Këshillit të Ministrave për zgjedhje paraprihet nga një njoftim i publikuar për plotësimin e vendit vakant të pozicionit të Komisionerit. Çdo shtetas shqiptar, që përmbush kriteret sipas nenit 81, mund të aplikojë për t'u propozuar për zgjedhje.

3. Para marrjes së detyrës, Komisioneri bën betimin para Kuvendit me këtë formulë: “Betohe se gjatë kryerjes së detyrës do të mbroj kurdoherë të drejtat kushtetuese për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si të drejta dhe liri themelore të njeriut”.

Neni 81

Kriteret e zgjedhjes

1. Çdo person që përmbush kriteret e mëposhtme mund të propozohet dhe të zgjidhet në pozicionin e Komisionerit:
 - a) të ketë mbushur moshën 35 vjeç;
 - b) të ketë arsim të lartë juridik;
 - c) të ketë vjetërsi pune jo më pak se 15 vjet në profesionin e juristit;
 - d) të ketë aftësi të spikatura profesionale;
 - e) të ketë njohuri të zgjeruara në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe veçanërisht me fushën e veprimtarisë së institucionit;
 - f) të mos jetë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë gjatë 10 viteve të fundit.
2. Personat që kanë mbajtur detyrën e anëtarit të Këshillit të Ministrave ose anëtarit të Kuvendit gjatë katër viteve të fundit nuk mund të zgjidhen në pozicionin e Komisionerit.

Neni 82

Përfundimi i mandatit

1. Mandati i Komisionerit përfundon, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 80.
2. Mandati i Komisionerit përfundon para kohe në rast të dorëheqjes. Në këtë rast, Komisioneri qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e Komisionerit të ri.
3. Komisioneri mund të shkarkohet vetëm me kërkesë të arsyetuar të Këshillit të Ministrave, e cila mbështetet nga jo më pak se një e treta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për shkak të:
 - a) shkeljeve të rënda që dëmtojnë rëndë reputacionin në publik dhe/ose funksionimin e zyrës, në veçanti, kur ka kryer një krim të rëndë; ose
 - b) paaftësisë fizike ose mendore për të përmbushur më tej funksionin e Komisionerit.Në këtë rast, Kuvendi vendos me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të tij.
4. Procedura e përzgjedhjes së Komisionerit fillon tre muaj përpara përfundimit të mandatit. Kur pozicioni i Komisionerit mbetet vakant për shkaqe të parashikuara në paragrafin 2 dhe 3, Këshilli i Ministrave i propozon Kuvendit kandidaturën e re brenda 1 muaji.
5. Gjatë periudhës që pozicioni i Komisionerit është vakant për shkaqet e parashikuara në paragrafin 3, detyrat dhe kompetencat e Komisionerit i kalojnë dhe ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Komisionerit.
6. Në përfundim të mandatit Komisioneri rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose i ofrohet një pozicion i barazvlefshëm me të.

Seksioni II

Kompetencat dhe detyrat

Neni 83

Kompetencat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

1. Komisioneri është përgjegjës për kryerjen e detyrave që i janë caktuar dhe ushtrimin e kompetencave që i janë dhënë atij në fushën e mbrojtjes së të dhënave në përputhje me këtë Ligj.

2. Komisioneri nuk ka autoritet për të mbikëqyrur veprimtaritë e përpunimit të kryera nga gjykatat në kuadër të veprimtarisë së tyre gjyqësore. Funkzioni i autoritetit mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave për veprimtarinë përpunuese të kryer nga pushteti gjyqësor në kuadër të veprimtarisë gjyqësore ushtrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 84

Detyrat dhe kompetencat përkatëse për zbatimin e tyre

1. Pavarësisht detyrave të tjera të përcaktuara sipas këtij Ligji, Komisioneri është përgjegjës për:

- a) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të e tij, si dhe publikimin e një raporti vjetor për këtë çështje;
- b) promovimin e rritjes së ndërgjegjësimit të publikut dhe të të kuptuarit të rreziqeve, rregullave, masave mbrojtëse dhe të drejtave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, edhe nëpërmjet botimeve periodike. Vëmendje të veçantë marrin aktivitetet që kanë në fokus fëmijët;
- c) dhënien e mendimeve për projekt aktet ligjore dhe nënligjore ose për projekte të tjera në sektorin publik, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;
- ç) dhënien e rekomandimeve për zbatimin e kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe siguron publikimin e tyre;
- d) publikimin e udhëzuesve me shpjegime për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky Ligj, që përfshijnë ndër të tjera, kohëzgjatjen e ligjshme të ruajtjes së të dhënave personale, ose, masat e sigurisë në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve të përpunimit;
- e) publikimin e Udhëzimeve me karakter detyrues të përgjithshëm për të gjitha aspektet e mbrojtjes së të dhënave të rregulluara sipas këtij Ligji, të cilat kërkojnë rregullim më të detajuar me karakter detyrues;
- f) hartimin dhe publikimin e klauzolave standarde kontraktuale për kontratat ndërmjet kontrolluesve dhe përpunuesve, sipas paragrafit 7 të nenit 31;
- g) këshillimin e kontrolluesve në kuadër të konsultimit paraprak sipas nenit 37 dhe autorizimin e përpunimit në përputhje me paragrafin 4 të nenit 37; gjithashtu është përgjegjës për mbështetjen e kontrolluesve nëpërmjet publikimit të listave në lidhje me kriteret për vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave sipas paragrafëve 7 dhe 8 të nenit 36, dhe paragrafit 4 të nenit 74;
- h) mbajtjen e një regjistri për dokumentimin e të gjitha njoftimeve të depozituara sipas nenit 40 dhe publikimin e një liste në lidhje me përjashtimet nga detyrimi për të njoftuar sipas gjermës (c) të paragrafit 2 të nenit 38;
- i) inkurajimin e hartimit të kodeve të sjelljes sipas nenit 44 dhe publikimin e kriterëve për akreditimin e një organi për monitorimin e kodeve të sjelljes sipas nenit 45; garantimin e

- miratimit të kodeve të sjelljes dhe akreditimin e një organi monitorues, kur kërkesat përmbushen, dhe për sa kohë që përmbushen;
- j) inkurajimin e vënies në zbatim të certifikimit, vulave dhe markave të mbrojtjes së të dhënave, me qëllim lehtësimin e përputhshmërisë me këtë Ligj; hartimin dhe publikimin e kriterëve për certifikimin në përputhje me nenin 46 dhe për akreditimin e organizmave të certifikimit në përputhje me nenin 47; akreditimin e organizmave të certifikimit, përfshirë miratimin e mekanizmave të tyre të certifikimit, kur kërkesat përmbushen dhe për sa kohë që ato përmbushen;
 - k) mbikëqyrjen, rregullimin dhe autorizimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale në përputhje me Seksionet 2 të Kapitujve II të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij Ligji, duke përfshirë, në veçanti, vendimet mbi përshtatshmërinë dhe klauzolat standarde të mbrojtjes së të dhënave;
 - l) kryerjen e hetimeve në lidhje me përputhshmërinë e veprimeve të përpunimit të të dhënave personale me këtë Ligj, kryesisht apo mbi bazë ankese;
 - m) garantimin e ushtrimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave siç parashikohet në Kapitullin III të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, përfshirë këshillimin për subjektet e të dhënave në këtë drejtim;
 - n) shqyrtimin e ankesave të paraqitura tek Komisioneri nga individë ose subjekte, organizata ose shoqata jofitimprurëse të cilat përfaqësojnë individin në përputhje me nenin 92, në rast shkelje të këtij Ligji;
 - o) rishikimin e përgjigjeve të dhëna nga autoritetet kompetente ndaj kërkesave të subjekteve të të dhënave në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tyre për akses ose për korrigjim ose fshirje sipas nenit 89;
 - p) vendosjen e sanksioneve administrative dhe penaliteteve të tjera sipas Kapitullit 2 të Pjesës V të këtij Ligji dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të e tyre;
 - q) vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë;
 - r) bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve të huaja, veçanërisht sa i takon çështjeve ndërkufitare;
 - rr) përfaqësimin e Zyrës së Komisionerit në aktivitetet e zhvilluara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Komisioneri harton një raport vjetor të cilin ia dërgon Kuvendit dhe raporton përpara tij sa herë i kërkohet. Gjithashtu mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme.

Neni 85 **Kompetencat ndihmëse**

1. Për përmbushjen e detyrave të tij sipas nenit 84, Komisioneri ka kompetencat e mëposhtme hetimore:

- a) njofton kontrolluesit ose përpunuesit për shkelje të pretenduara të këtij Ligji dhe kërkon qëndrimin e tyre lidhur me këto pretendime;
- b) urdhëron kontrolluesit dhe përpunuesit të japin çdo informacion që Komisioneri kërkon për kryerjen e detyrave të tij, përfshirë aksesin në dokumentacion;
- c) ka akses në çdo mjedis të kontrolluesit dhe përpunuesit, përfshirë pajisjet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave;
- d) kryen hetim administrativ në formën e auditimit të mbrojtjes së të dhënave;
- e) rishikon certifikimet e lëshuara nga organizmat certifikues në përputhje me nenet 46 dhe 47 të këtij Ligji;
- f) rishikon ligjshmërinë e përpunimit në kuadër të kufizimeve të të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas Kapitullit III të Pjesës III të këtij Ligji.

2. Për përmbushjen e detyrave sipas nenit 84, Komisioneri gëzon të gjitha kompetencat e mëposhtme korrigjuese:

- a) paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e synuara të përpunimit mund të rezultojnë në shkelje të dispozitave të këtij Ligji dhe i jep rekomandime atyre në lidhje me përputhshmërinë me Ligjin;
- b) tërheq vëmendjen për kontrollues ose përpunues kur veprimet e përpunimit kanë shkelur dispozitat e këtij Ligji;
- c) urdhëron kontrolluesit ose përpunuesit të zbatojnë kërkesat e subjektit të të dhënave për ushtrimin e të drejtave të tij ose të saj në përputhje me këtë Ligji;
- d) urdhëron kontrolluesit ose përpunuesit t'i kryejnë veprimet e përpunimit në përputhje me dispozitat e këtij Ligji, dhe kur është e mundur, në një mënyrë specifike dhe brenda një afati të caktuar;
- e) urdhëron kontrolluesit t'i komunikojnë cenimin e të dhënave personale subjekteve të të dhënave;
- f) vendos një kufizim të përkohshëm ose përfundimtar të përpunimit, përfshirë ndalimin e përpunimit;
- g) urdhëron korrigjimin, fshirjen ose çregjistrimin e të dhënave personale, si dhe bllokimin e përpunimit në përputhje me nenet 22, 23 dhe 24 dhe njoftimin e marrësve për këto veprime siç parashikohet në nenet 22 dhe 24;
- h) tërheq certifikimin ose urdhëron organizmin certifikues të tërheqë një certifikim të lëshuar në përputhje me nenet 46 dhe 47, ose urdhëron organizmin certifikues të mos lëshojë certifikime nëse nuk janë përmbushur ose nuk përmbushen më kriteret për certifikim;
- i) urdhëron pezullimin e kalimit të të dhënave tek një marrës në një vend të tretë ose tek një organizatë ndërkombëtare;
- j) vendos sanksione administrative në përputhje me nenin 95, të cilat mund t'i shtohen ose të zëvendësojnë masat e përmendura në gërmat a) deri tek i), në varësi të rrethanave të çdo rasti individual.

3. Kur një shkelje mund të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Komisioneri vepron në përputhje me paragrafin 4 të nenit 79.

Neni 86

Detyrimi për bashkëpunim

Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave të tij, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna menjëherë pas përfundimit të afateve të caktuara për të.

Neni 87
Publikimi

1. Udhëzimet, vendimet, dhe aktet e tjera nënligjore të Komisionerit, me karakter të përgjithshëm, botohen në Fletore Zyrtare.
2. Raporti vjetor si dhe raportet e posaçme publikohen.
3. Vendimet, autorizimet, rekomandimet ose aktet e tjera administrative që lidhen me raste individuale publikohen pas pseudonimizimit, në faqen zyrtare elektronike të Komisionerit kur çmohet e arsyeshme.

PJESA V
MJETET LIGJORE, PËRGJEGJËSIA DHE PENALITETET

KAPITULLI 1
Mjetet Ligjore dhe përgjegjësia

Neni 88
E drejta për t'u ankuar

1. Pavarësisht mjeteve të tjera administrative ose gjyqësore në dispozicion, çdo individ që pretendon se përpunimi i të dhënave të tij personale kryhet në shkelje të këtij Ligji, gëzon të drejtën të paraqesë ankim pranë Komisionerit.
2. Pasi vihet në dijeni nga Komisioneri për ankesën e depozituar, kontrolluesi ose përpunuesi, i cituar në ankesë, nuk bën ndryshime thelbësore në përpunimin e të dhënave personale në fjalë pa miratimin e Komisionerit ose deri në përfundim të shqyrtimit të ankesës nga ky i fundit.
3. Komisioneri vë në dijeni ankuesin mbi ecurinë e shqyrtimit të ankesës dhe merr vendim brenda afatit të caktuar nga Kodi i Procedurave Administrative.
4. Komisioneri lehtëson dorëzimin e ankesave nëpërmjet formularëve të paraqitjes së tyre, që mund të plotësohen gjithashtu në mënyrë elektronike, pa përjashtuar mjetet e tjera të komunikimit.
5. Komisioneri zbaton Kodin e Procedurave Administrative në shqyrtimin e ankesave.
6. Kryerja e detyrave të Komisionerit sipas këtij neni bëhet pa kundërshtim.
7. Kur ankesat janë qartazi të pabazuara ose të tepruara, veçanërisht për shkak të karakterit të tyre përsëritës, Komisioneri mund të refuzojë ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me ankesën. Komisioneri mban barrën e provës lidhur me pabazueshmërinë dhe natyrën e tepruar të ankesës.

Neni 89

E drejta për rishikimin e përgjigjes së një autoriteti kompetent

1. Marrësi i një përgjigje nga një autoritet kompetent në vijim të një kërkesë nga ana e marrësit për ushtrimin e të drejtave të tij sipas neneve 61 deri në 64, mund t'i kërkojë Komisionerit rishikimin e ligjshmërisë së përgjigjes si dhe, nëse është e mundur, ligjshmërinë e veprimeve të përpunimit që qëndrojnë në themel të përgjigjes.
2. Paragrafët 3 deri në 7 të Nenit 88 zbatohen për procedurat sipas paragrafit 1 të këtij neni, megjithatë, Komisioneri formulon përgjigjen në fjalë në përputhje me paragrafin 3 të nenit 61.

Neni 90

Kërkesa për urdhër paraprak bllokimi

Gjatë procedurës së ankimit sipas nenit 88, ankuesi mund t'i kërkojë Komisionerit, në përputhje me nenin 24, të lëshojë një urdhër paraprak bllokimi në lidhje me veprime specifike përpunimi nga pala tjetër, për shkak të rrezikut serioz dhe të pariparueshëm që i kanoset të drejtave të ankuesit sipas këtij Ligji. Komisioneri vendos pa vonesa, dhe në çdo rast, jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e kërkesës, nëse bllokimi i menjëhershëm është i nevojshëm dhe proporcional. Urdhri mund të revokohet në çdo kohë nga Komisioneri, sipas gjetjeve të hetimit administrativ, në rast të kundërt, është i detyrueshëm për palën tjetër, deri përfundim të shqyrtimit të çështjes.

Neni 91

E drejta për rishikim gjyqësor kundër Komisionerit

1. Çdo person fizik ose juridik, të cilit i adresohet një vendim i Komisionerit, gëzon të drejtën për t'u ankuar në gjykatën administrative kompetente siç rregullohet me Ligjin Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar. Vendimi i Komisionerit pasqyron informacion në lidhje me gjykatën kompetente dhe afatet për paraqitjen e ankimit në gjykatë.
2. Çdo ankues sipas neneve 88 dhe 89 gëzon gjithashtu të drejtën për t'u ankuar në gjykatën administrative kompetente, kur Komisioneri nuk e shqyrton ankesën e tij brenda afateve të përcaktuara në dispozitat e zbatueshme ligjore ose nuk e informon ankuesin mbi ecurinë e shqyrtimit të ankesës.

Neni 92

Përfaqësimi i subjekteve të të dhënave

Subjekti i të dhënave gëzon gjithashtu të drejtën të autorizojë një subjekt, organizatë ose shoqatë jofitimprurëse, të themeluar rregullisht në përputhje me ligjin, që ka pjesë të objektit të

aktivitetit sipas statutit veprimtari me interes publik dhe është aktiv në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, të paraqesë ankesë për llogari të tij, të ushtrorë të drejtat e përmendura në nenet 88-91 për llogari të tij dhe të ushtrorë të drejtën për dëmshpërblim sipas nenit 93.

Neni 93

E drejta për dëmshpërblim dhe përgjegjësia

1. Kushdo që ka pësuar dëm financiar ose jofinanciar për shkak të përpunimit të të dhënave personale në kundërshtim me këtë Ligj, gëzon të drejtën të përfitojë dëmshpërblim nga kontrolluesi ose përpunuesi për dëmin e pësuar, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.
2. Çdo kontrollues i përfshirë në përpunim është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga përpunimi i kryer në shkelje të këtij Ligj. Një përpunues është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga përpunimi, vetëm kur nuk ka vepruar në përputhje me detyrimet e përcaktuara më këtë Ligj që i zbatohen posaçërisht përpunuesve, ose, kur ai ka vepruar përtej ose në kundërshtim me udhëzimet e ligjshme të kontrolluesit.
3. Kontrolluesi ose përpunuesi përjashtohen nga përgjegjësia sipas paragrafit 2 nëse provojnë se nuk kanë qenë në asnjë mënyrë përgjegjës për veprimin që ka shkaktuar dëmin.
4. Kur më shumë se një kontrollues ose një përpunues, ose kur kontrolluesi dhe përpunuesi, janë të përfshirë në të njëjtin përpunim dhe janë përgjegjës, sipas paragrafit 2 dhe 3, për dëmin e shkaktuar nga përpunimi, secili prej tyre mban përgjegjësi për shumën e plotë të dëmit me qëllim që të garantohet dëmshpërblim efektiv i subjektit të të dhënave.
5. Kur një kontrollues ose përpunues ka dëmshpërbllyer plotësisht, në përputhje me paragrafin 4, dëmin e shkaktuar, ai kontrollues ose përpunues gëzon të drejtën e kthimit kundrejt kontrolluesve ose përpunuesve të tjerë të përfshirë në atë përpunim, sipas Kodit Civil, për atë pjesë të dëmshpërblimit që korrespondon me pjesën e tyre të përgjegjësisë për dëmin, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 2.

KAPITULLI 2

Sanksionet për shkeljen e këtij Ligji

Neni 94

Sanksionet administrative

Shkeljet e këtij Ligji nga kontrolluesit ose përpunuesit e të dhënave personale dënohen me sanksion administrativ në përputhje me nenet vijuese të këtij Kapitulli.

Neni 95

Kushtet e përgjithshme për vendosjen e sanksioneve administrative

1. Komisioneri garanton se vendosja e sanksioneve administrative në përputhje me këtë nen për shkeljet e këtij Ligji, siç përmendet në paragrafët 4, 5 dhe 6, do të ketë në çdo rast karakter

efektiv, proporcional dhe shtrëngues. Për procedurën e vendosjes së sanksioneve Komisioneri zbaton ligjin Nr. 10 279 "Për Kundërvajtjet Administrative".

2. Në varësi të rrethanave për çdo rast individual, sanksionet administrative shoqërohen me ose zëvendësohen nga masa korigjuese, sipas gërmave a) deri tek i) të paragrafit 2 të nenit 85. Vendimi në lidhje me vendosjen e sanksioneve administrative si dhe me shumën e sanksionit administrativ në secilin rast, merret duke mbajtur në konsideratë aspektet e mëposhtme:

- a) natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes, duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e përpunimit në fjalë, si dhe numrin e subjekteve të të dhënave të përfshirë dhe nivelin e dëmit të shkaktuar ndaj tyre;
- b) karakterin e qëllimshëm ose neglizhent të shkeljes;
- c) çdo veprim që kontrolluesi ose përpunuesi ka ndërmarrë për të zbutur dëmin e pësuar nga subjektet e të dhënave;
- d) shkallën e përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit, duke marrë parasysh masat teknike dhe organizative të zbatuara prej tyre në përputhje me nenet 32 dhe 41;
- e) çdo shkelje të ngjashme të mëparshme të kryer nga kontrolluesi ose përpunuesi;
- f) shkallën e bashkëpunimit me Komisionerin, për rekuperimin e shkeljes dhe zbutjen e efekteve të mundshme negative të saj;
- g) kategoritë e të dhënave personale të prekura nga shkelja;
- h) mënyrën në të cilën shkelja është sjellë në vëmendje të Komisionerit, veçanërisht nëse kontrolluesi ose përpunuesi kanë njoftuar për shkeljen, dhe nëse po, deri në çfarë mase e kanë bërë këtë;
- i) kur sipas paragrafit 2 të nenit 85 janë marrë më parë masa korigjuese kundrejt kontrolluesit ose përpunuesit në lidhje me të njëjtën çështje, merret në konsideratë zbatimi i atyre masave;
- j) respektimin e kodeve të miratuara të sjelljes në përputhje me nenin 44, ose mekanizmat e miratuar të certifikimit në përputhje me nenin 47; dhe
- k) çdo faktor tjetër rëndues ose lehtësues që lidhet me rrethanat e çështjes, si përfitimet financiare ose humbjet e shmangura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga shkelja.

3. Nëse një kontrollues ose përpunues me dashje ose si pasojë e neglizhencës, për të njëjtat veprime përpunimi ose për veprime të lidhura me të, shkel disa dispozita të këtij ligji, shuma totale e sanksionit administrativ nuk tejkalon shumën e parashikuar për shkeljen më të rëndë.

4. Shkeljet e dispozitave të mëposhtme, duke marrë parasysh edhe faktorët e përcaktuar në paragrafin 2, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1.000 000 000 lekë, ose në rastin e një ndërmarrjeje, deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë:

- a) detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit në përputhje me paragrafin 6 të nenit 8, paragrafi 5 të nenin 19, kapitulli IV i Pjesës II, me përjashtim të neneve 29, 46 dhe 47;
- b) detyrimet e organizmit certifikues, në përputhje me nenet 46 dhe 47;

c) detyrimet e organit monitorues, në përputhje me nenin 45, paragrafi 3;

5. Shkeljet e dispozitave të mëposhtme, duke marrë parasysh edhe faktorët e përcaktuar në paragrafin 2, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 lekë, ose në rastin e një ndërmarrjeje, deri në 4 % të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë:

a) parimet themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, në përputhje me nenet 6, 7, 8 dhe 9

b) të drejtat e subjekteve të të dhënave, në përputhje me nenet 19 deri te 27;

c) transferimet e të dhënave personale te një marrës në një vend të tretë ose një organizatë ndërkombëtare, në përputhje me nenet 11 deri te 14;

d) çdo detyrim sipas neneve 15 deri te 18;

6. Shkelja e detyrimit për bashkëpunim apo e çdo akti të Komisionerit, sipas paragrafit 1 të nenit 85, moszbatimi i një urdhri, apo kufizimi të përkohshëm ose përfundimtar të përpunimit, ose, pezullimi të shkëmbimit të të dhënave, i nxjerrë nga Komisioneri në përputhje me gërmën

b) të paragrafit 2 të nenit 85, duke marrë parasysh edhe faktorët e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 2 000 000 000 lekë, ose në rastin e një ndërmarrjeje, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë.

Neni 96

Ankimet

Ndaj dënimit administrativ me gjobë bëhet ankim në gjykatën kompetente në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ. Për paraqitjen e ankimit zbatohen kushtet e përcaktuara në ligjin Nr. 10 279 “Për kundërvajtjet administrative”. Vendimi i Komisionerit përmban informacion të në lidhje me gjykatën kompetente dhe afatet për paraqitjen e ankimit në gjykatë.

Neni 97

Ekzekutimi i gjobave

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i tyre. Pas përfundimit të afatit, vendimi kthehet në titull ekzekutiv dhe zbatohet në mënyrë të detyrueshme nga shërbimi përmbartimor, me kërkesë të Komisionerit.

2. Gjobat arkëtohen në masën 90% në buxhetin e shtetit. Pjesa tjetër e tyre, arkëtohet në llogarinë e veçantë të Zyrës së Komisionerit dhe përdoret sipas klasifikimit buxhetor.

PJESA VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 98

Shfuqizimet

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 99

Referencat e ligjeve të tjera

Ligjet e tjera të referuara në këtë ligj do të jenë të zbatueshme në kuptim të këtij ligji në formën e tyre përkatëse në momentin e zbatimit.

Neni 100

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për nxjerrjen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të akteve nënligjore në zbatim të paragrafit 2 të nenit 12, paragrafit 3 të nenit 15, paragrafit 7 dhe 8 të nenit 36, pikës c) të paragrafit 2 të nenit 38, paragrafit 6 të nenit 42, paragrafit 2 të nenit 45, paragrafit 1 të nenit 46, paragrafit 1 të nenit 47, paragrafit 4 të nenit 69 si dhe paragrafit 4 të nenit 74 të këtij ligji. Hyrja në fuqi e këtyre akteve mund të kushtëzohet me hyrjen në fuqi të dispozitave ligjore në zbatim të së cilës nxirret akti nënligjor.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të aktit nënligjor në zbatim të paragrafit 3 të nenit 79.

Neni 101

Vlefshmëria e akteve të Komisionerit

1. Aktet e Komisionerit me karakter të përgjithshëm, të publikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji qëndrojnë në fuqi, përveçse kur shfuqizohen nga Komisioneri.
2. Vendimet si dhe autorizimet me karakter specifik, të lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të qëndrojnë të vlefshme përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 102

Çështjet në proces

1. Për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, janë në proces pranë Komisionerit ose një gjykate, do të zbatohen dispozitat e këtij Ligji, për sa kohë paragrafi 2 nuk gjen zbatim.
2. Kundërvajtjet sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dënohen me gjobë sipas ligjit që ka qenë në fuqi në momentin kur është kryer shkelja.

Neni 103
Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Paragrafi 3 i nenit 34, nenet 36, 37, 44, 45, paragrafët 2, 3 dhe 5 të nenit 70, nenet 73 dhe 74, hyjnë në fuqi dy vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit.

K R Y E T A R I

[shqiptarja.com]